# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5635
E enjte, 22 nëntor 2018
çmimi 0.40 €

## Avramopoulosi rikonfirmon përkrahjen për vizat

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI FAQE 4-5

# Kosova duhet ta ndërpresë përkohësisht dialogun me Serbinë



Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka ftuar institucionet e Kosovës ta ndërpresin përkohësisht dialogun për normalizim të raporteve me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se kjo duhet të ndodhë për shkak të sjelljes armiqësore të Serbisë ndaj Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe për ta ndalur diskutimin për lëvizje të kufijve. Sipas Tahirit, dialogu që po zhvillohet në Bruksel ndërmjet dy presidentëve nuk është në interes të Kosovës. Ajo ka bërë me dije se Kosova nuk duhet të bëhet pjesë e këtij procesi derisa Serbia të fillojë të sillet në bazë të parimeve të fqinjësisë së mirë.

## AKTUALE

**DËSHTIMI I KOSOVËS NË INTERPOL, SHKAQET KRYESORE** F. 12



Prof. Lisen BASHKURTI

**MËSIMET QË DUHEN NXJERRË PAS VOTIMIT NË INTERPOL** F. 12



Jakup KRASNIQI

**KOSOVA PO MERR PËRSIPËR ANGAZHIMIN E PLOTË PËR SUNDIMIN E LIGJIT** F. 7

**KURTI: SERBIA NA KA BORXH MBI 22 MILIARDË EURO** F. 5

## Qeveria ka pezulluar vendimet për kthimin e pronave shoqërore te komunat

FAQE 7



# Taksë doganore 100 për qind për Serbinë

Qeveria e Republikës së Kosovës të mërkurën ka marrë vendim që ta rrisë në 100 për qind taksën doganore për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja Hercegovina. Me këtë vendim do të ndalohet edhe importimi i produkteve që në etiketa dhe deklarata përcjellëse shkruan "Kosovë dhe Metohi", "Kosovë 1244", "Kosovë UNMIK". Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se ky vendim është marrë për shkak se Serbia në vazhdimësi ka shkelur Marrëveshjen e CEFTA-s në raportet tregtare me Kosovën. Ndërkaq ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se propozimi për rritjen e taksës ndaj produkteve serbe ka për qëllim fuqizimin e ekonomisë së Kosovës FAQE 3



## EKONOMI

**NË BUXHETIN E 2019-s PARASHIHET RRIJE EKONOMIKE 4.7 PËR QIND** F. 9

**REÇICA THOTË SE DERI NË FUND TË MUAJIT DO TË MIRATOHET KONTRATA KOLEKTIVE** F. 8

## SPORT

**SAHITI: SYNIMI I KOSOVËS, EVROPIANI** F. 8

**PASUROHEN 'DARDANËT'** F. 8



RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Veseli: BE-ja duhet të vendosë këtë vit për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka zhvilluar takime të ndara me kryetarin e Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit të Belgjikës, Siegfried Bracke dhe kryetarin e Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë të Dhomës së Përfaqësuesve, Dirk Van der Maelen. Edhe në këto takime temë bosht e bisedës ishte agjenda evropiane e Kosovës, përkatësisht nevoja për marrjen e vendimit brenda këtij viti për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Kryeparlamentari Veseli konfirmoi edhe një herë se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara dhe se qytetarët e saj meritojnë të lëvizin lirshëm në Zonën Shengen, sikurse qytetarët e tjerë evropianë. Po ashtu, Veseli theksoi nevojën e forcimit të bashkëpunimit midis Kosovës dhe Belgjikës në të gjitha sferat, me theks të veçantë në atë të ekonomisë.

Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit belg, Siegfried Bracke dhe kryetari i Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë i kësaj Dhome, Dirk Van der Maelen, konfirmuan vazhdimin e mbështetjes së shtetit të tyre për Kosovën edhe në të ardhmen si në rrafshin ndërkombëtar, po ashtu edhe në zhvillimet e brendshme.

Kryeparlamentari Veseli tha pas takimeve se qytetarët e Kosovës duhet ta dinë që në mesin e Bashkimit Evropian Kosova ka miq të mëdhenj. Ai tha se vizitat e tij nëpër këto vende kanë të bëjnë me përçimin e zërit të Kosovës te lidershipet e tyre dhe konfirmimin e vizionit të saj të palëkundur euroatlantik, me kërkesën për hapa më të shpejtë në këtë rrugëtim, veçanërisht për procesin në pritje, liberalizimin e vizave.



Lidhur me liberalizimin e vizave, kreu i Kuvendit tha se vetë përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, insistonte se do t'u qëndrohet në krah qytetarëve të Kosovës lidhur me këtë proces.

# Avramopoulosi rikonfirmon përkrahjen për vizat

**Komisionari për Punë të Brendshme i BE-së, Dimitris Avramopoulos, gjatë takimit me ministren e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, karikonfirmuar përkrahjen e tij të plotë për liberalizimin e vizave pranë organeve vendimmarrëse në Bruksel për votimin për në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në fillim të dhjetorit**

"Epoka e re"

BRUKSEL, 21 NËNTOR - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, u prit në takim nga komisionari Dimitris Avramopoulos, përgjegjës për Migrim, Punë të Brendshme dhe Shtetësi dhe, me këtë rast, ka theksuar rëndësinë e lëvizjes së lirë për shtetasit e Kosovës. "Ne, nga dita e marrjes së udhërrëfyesit për liberalizmin e vizave, më 2012, nga niveli qendror dhe lokal, kemi qenë të përkushtuar për zbatimin sa më të shpejtë të kritereve për liberalizim", ka thënë ministrja Hoxha, duke shtuar se së bashku me BE-në Kosova ka arritur deri këtu.



"Presim nga ju dhe instancat vendimmarrëse, të ndikojnë dhe ofrojnë përkrahjen që edhe Këshilli i Ministrave ta heqë kufizimin e lëvizjes së lirë, ta heqë pabarazinë ndaj shtetasve të Kosovës dhe ta gëzojmë edhe ne lëvizjen e lirë, bashkë me qytetarë të tjerë të Ballkanit dhe të Evropës", është shprehur Hoxha.

Komisionari për Punë të Brendshme i BE-së, Dimitris Avramopoulos, ka vlerësuar dhe mirëpritur angazhimin e Kosovës dhe të bartësve të përgjegjësive institucionale për lobim dhe marrjen e përkrahjes nga vendet e veçanta për votimin pro në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Ai ka theksuar se përmbushja e kritereve për liberalizim është konfirmuar nga komisioni, si dhe me vendimin e Komitetit të Parlamentit Evropian për Liri Civile (LIBE) dhe votimin në Parlamentin Evropian. Ai e rikonfirmoi përkrahjen e tij të plotë për liberalizimin e vizave pranë organeve vendimmarrëse në Bruksel për votim pro në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në fillim të dhjetorit.

## Meta dhe Kitaroviqi takojnë arbanasit e Zarës

TIRANË, 21 NËNTOR - Gjatë vizitës në Kroaci, presidenti i Shqipërisë Ilir Meta ka zhvilluar një takim me homologen kroate Kolinda Grabar-Kitaroviq. Në kuadër të Vitit Kombëtar të Heroit tonë Gjergj Kastrioti Skënderbeut të dy presidentët vizituan bashkësinë e Arbanasve të Zarës, "oazën e shqiptarëve në Kroaci", ku u takuan dhe u përshëndetën përzemërsisht me përfaqësuesit arbanas, me prefektin dhe kryetarin e Bashkisë së Zarës, autoritetet vendore dhe drejtuesit fetarë.

Presidenti Meta dhe presidentja kroate Grabar-Kitaroviq u ndalën fillimisht në Kishën "Gospe Loretske" (Zonja Jonë e Loretos), e ndërtuar gati 300 vjet më parë si strehë shpirtërore dhe mbrojtëse e banorëve të rinj të Zarës.

Si dhe më pas vizituan shkollën fillore "Dr. Krune Krsti?a", në të cilën fëmijët e bashkësisë arbanase mësojnë dhe shkollohen në gjuhën shqipe. "Këtu janë shkolluar breza të shumtë arbanasish duke nxjerrë plejada akademikësh, studiuesish, shkrimtarësh e artistësh, të cilët krijuan vlerën e përbashkët sa arbneshe, aq edhe kroate", vuri në dukje presidenti Meta.

Presidentja e Kroacisë theksoi se "arbanasit kanë një kontribut të jashtëzakonshëm për krijimin dhe mbrojtjen e Kroacisë. 11 luftëtarë Arbanas nga famullia e Zarës dhanë jetën për atdhe".



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

# Taksë doganore 100 për qind për Serbinë



Qeveria e Republikës së Kosovës të mërkurën ka marrë vendim që ta rrisë në 100 për qind taksën doganore për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja Hercegovina. Me këtë vendim do të ndalohet edhe importimi i produkteve që në etiketa dhe deklarata përcjellëse shkruajnë emërtimet "Kosovë dhe Metohi", "Kosovë 1244", "Kosovë UNMIK". Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se ky vendim është marrë për shkak se Serbia në vazhdimësi ka shkelur Marrëveshjen e CEFTA-s në raportet tregtare me Kosovën. Ndërkaq ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se propozimi për rritjen e taksës ndaj produkteve serbe ka për qëllim fuqizimin e ekonomisë së Kosovës

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e së mërkurës ka marrë vendim për rritjen e taksës doganore nga 10 për qind në 100 për qind ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Me anë të këtij vendimi do të ndalohet importi i produkteve në etiketat dhe deklarata përcjellëse të atyre që shkruajnë "Kosovë dhe Metohi", "Kosovë 1244", "Kosovë UNMIK". Propozuesi i ngritjes së kësaj takse, ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, ka thënë para kabinetit qeveritar se ky vendim është marrë në vazhdën e përpjekjeve për t'i fuqizuar prodhuesit vendorë, për ta fuqizuar ekonominë dhe shtetësinë e Kosovës.

Ai ka thënë se MTI-ja do të fokusohet në rritjen e mirëqenies së qytetarëve duke krijuar kushte sa më të volitshme për prodhuesit dhe tregtarët vendorë. "Të nderuar qytetarë, prodhues, tregtarë, ju ftoj t'i bashkëngjiteni kauzës sonë për zhvillim të vendit, për rritjen e punësimit dhe mirëqenies për qytetarët. Të nderuar prodhues, kërkoj nga ju të fokusoheni në cilësi. Produktet duhet të arrijnë cilësinë e standardit më të lartë në mënyrë që konsumatori - qytetari i Republikës të Kosovës, mos të ketë asnjë mëdyshje për përzgjedhjen e konsumit ditor. Të nderuar tregtarë, le të bashkohemi dhe të bëjmë zgjidhje kreative. Ta hulumtojmë tregun së bashku dhe të gjejmë vende të tjera për të bashkëpunuar. Rritja e eksportit të produkteve dhe jo të mirave materiale, duhet të bëhet prioritet. Andaj shpresojmë në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj në rrugëtimin tonë për ta fuqizuar Kosovën, prodhuesin dhe tregun e saj", ka deklaruar Shala, duke shtuar se prodhuesit kosovarë ballafaqohen me barriera të ndryshme si në Serbi, po ashtu edhe në Bosnje, prandaj produktet e Kosovës nuk mund të hyjnë në tregjet e këtyre dy vendeve.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se rritja e taksës prej 100 përqindësh ndaj Serbisë ka ardhur për shkak të bllokimit të Kosovës për t'i gëzuar të drejtat e CEFTA-s. "Jemi dëshmitarë që një kohë të gjatë se Kosova është bllokuar, nuk është lejuar t'i gëzojë të drejtat e CEFTA-s. Është penguar përmes origjinës së mallit, pra duke mos e njohur origjinën e mallit, është penguar në transport, analiza dhe në çdo instrument tjetër. CEFTA nuk ka funksionuar në mes të Kosovës dhe Serbisë, dhe kjo është dëshmi. Serbia është duke e cenuar edhe sigurinë kombëtare, pra kjo është qasja që ka ardhur nga Serbia në vazhdimësi në periudhat e fundit", ka deklaruar Haradinaj. Ai ka kërkuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe të gjitha institucionet relevante, që ta largojnë dhe ta ndalojnë importin dhe hyrjen potenciale në treg të të gjitha produkteve, të cilat nuk i referohen dhe janë në kundërshtim me emërtimin zyrtar dhe kushtetues të Republikës së Kosovës. Haradinaj ka thënë se marrja e këtij vendimi për rritjen e taksës prej 100 përqindësh nuk është bërë nga dëshira, por për shkak të sjelljes shqetësuese të Serbisë ndaj Kosovës. "Ky është realiteti dhe kjo masë e ndërmarrë sot duhet të zbatohet njëqind për qind", ka theksuar ai.

## Qeveria ndan 600 mijë euro për zjarrfikësit

Me qëllim të realizimit të rregullimit të statusit të zjarrfikësve të Republikës së Kosovës, kabineti qeveritar të mërkurën ka ndarë mjete në vlerë 600 mijë euro për kompensimin e orëve shtesë të zjarrfikësve. Po në këtë mbledhje Qeveria ka marrë vendim për ndarjen e 120 mijë eurove për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet që do të krijohen nga realizimi i mbledhjes së përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë që do të mbahet më 26 nëntor në Pejë. Qeveria ka ndarë 17 580 euro për përmbushjen e kontributit vjetor të Republikës së Kosovës në Qendrën Rajonale të Nismës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë me seli në Shkup për vitin 2018.

## Qeveria ka pezulluar vendimet për kthimin e pronave shoqërore te komunat

PRISHTINË, 21 NËNTOR (ER) - Kabineti qeveritar të mërkurën ka miratuar vendimin për pezullimin e të gjitha vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për kthimin e pronave shoqërore që administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit te komunat e Kosovës. "Ky vendim anulon të gjitha vendimet e Qeverisë për kthimin e pronave shoqërore te komunat e Kosovës për qëllim të realizimit të interesit publik për të cilat i janë drejtuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit e për të cilat verifikohet se ka kontrata të shitjes, apo në të cilat ka masa të përkohshme nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës", është thënë në komunikatën e Qeverisë. Nga ky vendim është përjashtuar vendimi për Parkun Inovativ në Prizren, Zonën Industriale Amerikane në Gjakovë dhe ai për ndërtimin e Ambasadës së Gjermanisë në Prishtinë. Me qëllim të sqarimeve të mëtejme lidhur me kërkesat e komunave është themeluar grupi punues i cili do t'i paraqesë rekomandimet dhe raportin me shkrim lidhur me këtë çështje brenda një jave.



Flet për "Epokën e re", Edita Tahiri

# Kosova duhet ta ndërpresë për



**Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka ftuar institucionet e Kosovës ta ndërpresin përkohësisht dialogun për normalizim të raporteve me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se kjo duhet të ndodhë për shkak të sjelljes armiqësore të Serbisë ndaj Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe për ta ndalë diskutimin për lëvizje të kufijve. Sipas Tahirit, dialogu i tanishëm që po zhvillohet në Bruksel ndërmjet dy presidentëve nuk është në interes të Kosovës. Ajo ka bërë me dije se Kosova nuk duhet të bëhet pjesë e këtij procesi derisa Serbia të fillojë të sillet në bazë të parimeve të fqinjësisë së mirë**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 NËNTOR -

**"Epoka e re":** *Znj. Tahiri, Serbia sërish përdori të gjitha mjetet për ta kundërshtuar anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Cili është komenti juaj për këtë qëndrim armiqësor të Serbisë?*

**Tahiri:** Ky ishte një dështim i Interpolit, sepse lejoi të triumfojë politika e krimit e sponsorizuar nga Serbia. Ky dështim i Interpolit jo vetëm që la Kosovën jashtë anëtarësimit, por dobësoi edhe stabilitetin në rajon. Të gjithë e dimë rëndësinë e Interpolit në funksion të sundimit të ligjit dhe luftës kundër krimit të organizuar. Mendoj se kjo ishte humbje për Interpolin, për rajonin dhe për Kosovën.

**"Epoka e re":** *Po përgjegjësia e institucioneve të Kosovës në këtë rast, cila është?*

**Tahiri:** Diplomacia e Kosovës duhet ta ndryshojë qasjen, sepse politikëbërja e diplomacisë së Kosovës është jashtëzakonisht e dobët. Nuk ka një strategji të mirëfilltë dhe vizionare të politikës së jashtme të Kosovës. Kjo vjen si pasojë e mungesës së kapaciteteve për t'u marrë me sfidat e diplomacisë ndërkombëtare të cilat janë komplekse dhe strategjike.

**"Epoka e re":** *Meqenëse Serbia vazhdimisht po vepron në mënyrë destruktive ndaj Kosovës në arenën ndërkombëtare, si duhet të veprojë Kosova në raport me procesin e Brukselit për normalizim të raporteve në mes të dy vende?*

**Tahiri:** Kosova duhet të mendoj mirë në raport me relacionet me Serbinë dhe dialogun e Brukselit, sepse ky qëndrim armiqësor i Serbisë ndaj Kosovës në planin e integrimit ndërkombëtare dëshmon se Serbia nuk ka gatishmëri që të bëjë fqinjësi me shtetin e Kosovës. Përkundrazi, është e orientuar që të krijojë situata të tensionuara që nuk e ndihmojnë paqen dhe stabilitetin në rajon dhe e nxjerrin Serbinë si një faktor që nuk është i përgatitur për integrimet evropiane. Për fat të keq, Serbia mbetet me logjikën e saj të vjetër, me mentalitet rus, qëndrim hegjemonist dhe destruktiv. Kjo në radhë të parë është keq për Serbinë.

**"Epoka e re":** *A do të thotë kjo se Kosova duhet ta ndërpresë dialogun me Serbinë?*

**Tahiri:** Ndoshta Kosova duhet të mendojë ta ndalë dialogun me Serbinë në Bruksel përkohësisht. Kjo duhet të ndodhë për ta ndalur diskutimin për kufirin në mes të dy vendeve. Këtu i takon edhe vetë presidentit të Kosovës që ta ndalë diskutimin për këtë temë, por edhe vetë Serbia nuk

# kohësisht dialogun me Serbinë



duhet të lejojë që agjendat ruse të kenë ndikim në këto procese. Po ashtu, edhe BE-ja duhet ta bëjë të qartë që Ballkani mund të jetë stabil dhe në paqe vetëm nëse respektohen kufijtë e gjashtë shteteve të ballkanike, duke përfshirë edhe Kosovën. Vetëm nëse BE-ja respekton parimet e veta për shtet shumetnik, përndryshe i gjithë procesi në Ballkan mund të marrë kahe të paparashikueshme me pasoja të rënda, deri te luftërat e reja.

**"Epoka e re":** *Pra, sipas jush, është koha që Kosova ta ndalë dialogun me Serbinë?*
**Tahiri:** Mendoj se Kosova duhet ta ndërpresë përkohësisht dialogun me Serbinë duke bërë me dije dy arsye: E para, për shkak të qëndrimit armiqësor të Serbisë ndaj Kosovës në arenën ndërkombëtare. E dyta, për shkak se Kosova, populli i saj dhe i gjithë spektri politik, kundërshton fuqishëm prekjen e kufijve të shtetit. Këto janë dy arsyet pse ky dialog duhet të ndërpritet përkohësisht në mënyrë që të bëhet riformulimi i politikave për fqinjësi të mirë në kuadër të dialogut. Me politikat e fqinjësisë së mirë dhe njohjen reciproke ky dialog i Brukselit mund të japë rezultate dhe një marrëveshje që siguron paqe dhe stabilitet në rajon.

**"Epoka e re":** *Mendoni se Kosova mund ta ndalë këtë proces përkundër presonit të madh ndërkombëtar për ta vazhduar atë?*
**Tahiri:** Jo vetëm ky proces, po të gjitha proceset që i zhvillon Kosova në politikën e brendshme dhe në atë të jashtme duhet të jenë në pajtim me interesat shtetërore të Kosovës. Ky dialog, siç po shkon tani, është kundër interesave shtetërore të Kosovës. Sigurisht se Kosova nuk duhet të ngutet dhe të jetë palë në dialog nëse ky proces po shkon drejt prekjes së kufijve të Kosovës dhe praktikisht cenimit të shtetësisë dhe sovranitetit e integritetit territorial të saj. Tani Kosova duhet të bëjë me dije se palë në këto bisedime do të jetë vetëm kur të ndalet tema e kufijve dhe kur Serbia t'i ndalë sjelljet armiqësore ndaj Kosovës.

**"Epoka e re":** *Nuk do të ketë Kosova ndonjë sanksion të mundshëm ndërkombëtar nëse do ta ndalte dialogun?*
**Tahiri:** Nuk ka sanksion më të madh për Kosovën sesa që të bisedohet për kufijtë e saj. Ky është sanksionimi më i madh dhe dëmi më i madh që iu ka bërë Kosovës që nga përfundimi i luftës. Që 20 vjet po punojmë për ndërtim të shtetit, duke qenë kontributdhënës të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe në momentin që shihet se një proces po shkon kundër interesave tona, ai proces duhet të ndërpritet. Pastaj të vihet në shprehje konsolidimi i brendshëm i skenës politike-institucionale të Kosovës, duke e nxjerr një platformë për dialogun e Brukselit me të cilën vija e kryesor e kuqe duhet të jetë që askush nuk mund të bisedojë për temën e kufijve. Po ashtu, përmes kësaj platforme duhet të jepet mesazhi i qartë se me qëndrimet armiqësore të Serbisë cenohen parimet e fqinjësisë së mirë. Dhe derisa Serbia nuk disiplinohet dhe nuk ndryshon qasje në raport me Kosovën, nuk ka mundësi të jetë palë për dialog.

**"Epoka e re":** *Kuvendi i Kosovës, pozita dhe opozita nuk po mund ta miratojnë një rezolutë të përbashkët e cila do të ndalonte diskutimin për kufij.*
**Tahiri:** Tani kur Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur ta miratojë as platformën për dialog dhe as ta autorizojë delegacionin e Republikës së Kosovës për dialog, dhe presidenti i Kosovës në takimet ndërkombëtare vazhdon ta promovojë idenë e ndryshimit të kufijve, ne jemi në një pozitë të rendë dhe të disfavorshme. Fakti që ka dështuar Kuvendi t'i marrë përgjegjësitë shtetërore, me fjalë të tjera Kuvendi po ua bartë përgjegjësinë qytetarëve. Qytetarët e Kosovës duhet të flasin dhe kjo mund të ndodhë në format e ndryshme demokratike për t'ia bërë me dije edhe Kuvendit dhe të gjitha institucioneve shtetërore se, meqenëse ata dështuan, tani populli është sovrani. Në fund të fundit, në shtetet demokratike sovrani është populli dhe ai përmes votës e bartë sovranitetin te Kuvendi i Kosovës. Tani kur Kuvendi po dështon ta ushtrojë sovranitetin shtetëror, kompetenca i kthehet popullit për të vendosur, sepse nuk ka mbetur rrugë tjetër.

**"Epoka e re":** *Kjo i bie se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja?*
**Tahiri:** Një prej alternativave janë zgjedhjet e reja. Alternativë tjetër është që qytetarët përmes manifestimeve demokratike të dëshmojnë se Kosovën e mbrojnë me çdo çmim siç e kemi mbrojtur edhe në periudhën e okupimit. Është koha të flasë populli, sepse institucionet po dështojnë. Institucionet kanë edhe një shans që të nguten dhe t'i nxjerrin dokumentet relevante dhe t'i sigurojnë qytetarët e Kosovës se tërësia territoriale e Kosovës dhe kufijtë janë të paprekshëm. Nëse ndodh kjo, sovraniteti është tek institucionet. Përndryshe, Kuvendi ia ka kthyer sovranitetin popullit për të vendosur.

## Kurti: Serbia na ka borxh mbi 22 miliardë euro




PRISHTINË, 21 NËNTOR (ER) - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një konferencë për media mbajtur të mërkurën, ka shpalosur kërkesat ndaj Serbisë për të cilat subjektet politike mund të bëhen bashkë në Kuvendin e Kosovës. Kurti ka thënë se nuk mund të ketë pajtim me Serbinë, ashtu siç pretendon presidenti Hashim Thaçi, pa pasur pajtim edhe subjektet politike mbi raportin me Serbinë.

Ai ka thënë se është votuar me shumicë dërrmuese Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ngjashëm do të mund të votohej edhe qëllimi i Vetëvendosjes për raportin e ri me Serbinë. "Nuk mund të pajtohemi me Serbinë, siç pretendon, p. sh., presidenti, nëse nuk pajtohemi me njëri-tjetrin mbi raportin me Serbinë. Unë jam shumë optimist që për qëllimet tona që përkthehen në kërkesa ndaj Serbisë, ne mund të bëhemi bashkë në Kuvendin e Republikës. Ashtu siç është votuar me shumicë dërrmuese projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ngjashëm do të mund të votohej qëllimi ynë për raportin e ri me Serbinë, të cilin do ta karakterizojë fqinjësia e mirë, paqja dhe integrimi evropian", ka thënë Kurti. Ai ka thënë se është optimist se do të ketë konsensus në Kuvend dhe në Qeveri për kërkesat e Kosovës ndaj Serbisë pasi, sipas tij, faktet janë të forta.

Më tutje, Kurti ka folur për dëmet e luftës të shkaktuara nga Serbia. "Serbia nuk po na i kthen regjistrat civilë dhe librat kadastralë. Ekonomia e Kosovës ngecën edhe për shkak të kadastrës së munguar ose të dobët. Sipas vlerësimeve të vitit 2001 të Institutit 'Riinvest', dëmet dhe pasojat nga lufta në ndërmarrjet shoqërore janë rreth 1.3 miliard marka gjermane. Dëmet në ndërmarrjet publike komunale arrijnë rreth 130 milionë marka gjermane. Vlerësohet se rreth 92 për qind e ndërmarrjeve private pësuan dëme të konsiderueshme nga lufta. Dëmi i përgjithshëm tejkalon 22 miliardë euro, sipas Institutit 'Riinvest'. 22 miliardë euro Serbia na i ka borxh neve", është shprehur Kurti.

# Dështimi i Kosovës në Interpol, shkaqet kryesore



Prof. Lisen BASHKURTI

Prej disa kohësh politika, diplomacia dhe media e Kosovës nisën të flisnin lidhur me kandidimin e Republikës së Kosovës në Interpol. Në këtë 'fushatë' nuk munguan edhe propaganda, retorika politike dhe euforitë diplomatike. Në një intervistë të dhënë në "Evropa e Lirë", pak javë më parë, pyetjes se si e shihja unë kandidimin e Kosovës për anëtarësi në Interpol, iu pata përgjigjur me bindje se Kosova më shumë po i largohet sesa po i ofrohet këtij objektivi. Nuk ishte aspak profeci, por opinion analitik.

Kosova e kishte për herë të dytë kandidimin për në Interpol. Aplikimi i parë për anëtarësim të Kosovës në Interpol është bërë në vitin 2010 nga MPB-ja e Qeverisë së Kosovës. Kërkesa për aplikim atëherë iu dorëzua sekretarit të përgjithshëm të Interpolit, kërkesë e cila atëherë nuk u kalua tek organet e tjera të Interpolit për shqyrtim të mëtejshëm. Ndërsa kërkesa e dytë e institucioneve të Kosovës për anëtarësim në Interpol u bë në prill të vitit 2015, nga kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa. Aplikimi i dytë u dorëzua në Interpol përmes misionit të UNMIK-ut.

Në seancën e votimeve në Asamblenë e Përgjithshme të Interpolit, më 20 dhjetor 2018 Kosova dështoi për t'u bërë anëtare me të drejta të plota të kësaj agjencie të rëndësishme të Kombeve të Bashkuara. Pas dështimit në raundin e parë dhe përpjekjes për raundin e dytë, Kosova nuk arriti t'i merrte 2/3 e votave për t'u bërë pjesë e njërës prej agjencive më të rëndësishme të sigurisë në botë, në kuadrin e Kombeve të Bashkuara.

Jo vetëm mosvotimi, por edhe treguesit sasiorë të rezultatit përfundimtar të procesit të votimit në Asamblesë e Përgjithshme të Interpolit për Kosovën ishin mjaft shqetësuese. Konkretisht vetëm 68 vende ishin për, 51 vende ishin kundër dhe 16 vende abstenuan. Këto vota treguan një mbështetje mjaft të ulët për Kosovën në këtë agjenci të OKB-së. Madje votimi evidentoi tërheqje të shumë shteteve që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës nga vijimi i mbështetjes së saj.

Cilat janë shkaqet kryesore të këtij dështimi ndërkombëtar të Kosovës?

## 1. Lobimi serb agresiv në rritje kundër Kosovës

Një prej shkaqeve kryesore të dështimit të anëtarësimit të Kosovës në Interpol, madje të arritjes së një rezultati shumë të ulët në këtë votim, ishte lobimi shumë agresiv i politikës së jashtme dhe diplomacisë së Serbisë. Një sjellje e tillë politike-diplomatike u ndoq nga Serbia edhe disa vjet më parë kur Kosova tentoi të anëtarësohej në UNESCO. Politika dhe diplomacia serbe po shfrytëzojnë të gjitha avantazhet në marrëdhëniet ndërkombëtare, përkundër Kosovës, për bllokimin e zgjerimit të njohjeve të mëtejshme, madje po punojnë fort për tërheqjen e njohjeve për Republikën e Kosovës nga shtete të caktuara. Pavarësisht prej angazhimit formal të Serbisë në marrëveshjen e prillit 2013 për të mos bllokuar anëtarësimin e Kosovës në agjenci ndërkombëtare dhe nisma rajonale, e vërteta është se Serbia jo vetëm se nuk po e zbaton këtë angazhim, por po e shkel atë me të dyja këmbët. Ky qëndrim është një provë e re që Serbia aktuale nuk respekton marrëveshjet e firmosura me Kosovën, pavarësisht prej ndërmjetësimit dhe garantimit nga BE-ja.

Për Serbinë Kosova ende mbetet një ndarje e thjeshtë administrative brenda kufijve politikë të shtetit serb dhe asgjë më shumë. Ky qëndrim konsistent i Serbisë nuk jep shpresa edhe për shumë kohë se me të Kosova mund të arrijë marrëveshje të gjerë për normalizimin e marrëdhënieve. Lidershipi i Kosovës nuk duhet të ushqejë asnjë iluzion lidhur me politikën dhe diplomacinë aktuale të Serbisë. Çdo iluzion në këtë aspekt do të ishte me pasoja serioze për Kosovën.

## 2. Politika e jashtme, diplomacia e Kosovës dhe Shqipëria

Dështimi i Kosovës në Interpol dhe treguesit konkretë të këtij rezultati shënojnë hapa seriozë prapa të politikës së jashtme dhe diplomacisë së Kosovës. Politika e jashtme e Kosovës po përjeton një konfuzion të vërtetë. Po injorohen parimet kryesore kushtetuese për politikëbërjen dhe vendimmarrjen në politikën e jashtme. Protagonizmi ekstremist i presidentit, përplasjet institucionale qeveri-parlament-president si dhe rivalitetet politike partiake po rrënojnë bazat e politikës së jashtme të Kosovës, pozitën ndërkombëtare të saj dhe aftësinë negociuese me Serbinë.

Në politikën e jashtme dhe diplomaci, ku duhej të ishte më e fortë, Kosova po shpaloset më dobët. Në politikën e jashtme dhe diplomaci, ku duhej të kishte konstitucionalitet, Kosova po shpalos konfiktualitet. Në politikën e jashtme dhe diplomaci, ku duhej të kishte konsensus, Kosova po shpalos përçarje. Në politikën e jashtme dhe diplomaci, ku duhej të kishte sukses, Kosova po dëshmon regres. Dhe në këtë situatë tejet konfuze të politikës së jashtme të Kosovës protagonistët kryesorë të lidershipit aktual kosovar, presidenti, qeveria dhe parlamenti, po përpiqen meritat t'i rrokin për vete, ndërsa dështimet t'i lënë jetimë. Konfuzion në vend të strategjisë. Kjo është situata aktuale e politikës së jashtme të Kosovës.

Kriza e politikës së jashtme të Kosovës e ka shndërruar institucionin kryesor të saj, Ministrinë e Punëve të Jashtme, në një shtojcë të konjukturave politike të brendshme, ndërsa diplomacinë po e bën përherë e më diletante dhe më të plogësht. Për këtë diletantizim dhe plogështi të diplomacisë së Kosovës pa pikë dyshimi kanë ndikuar lideshipi në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe trupi diplomatik kosovar i akredituar jashtë.

Udhëheqja e Ministrisë së Punëve të Jashtme e ka dobësuar së tepërmi rolin e saj në politikëbërje dhe vendimmarrje, në përpilimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të shtetit të Kosovës. E përfshirë në kaosin e iniciativave të instancave të larta të vendit, e ballafaquar me protagonizëm egoist presidencial, e paralizuar nga përplasjet ndërinstitucionale dhe e përfshirë në rivalitetet politike partiake, Ministria e Punëve të Jashtme e ka humbur funksionin e saj kushtetues, ndërkohë shefi i saj po luan më shumë si kryetar i një partie të vogël sesa si drejtues i politikës së jashtme dhe i diplomacisë shtetërore të Republikës së Kosovës.

Nga ana tjetër, nepotizmi, politizimi dhe fryma e partitizmit e shtrirë në çdo qelizë të administratës së Kosovës kanë gufatur dhe amatorizuar skajshmërisht edhe instrumentin kryesor të zbatimit të politikës së jashtme, diplomacinë e Kosovës. Për këtë krizë serioze të shërbimit diplomatik të Kosovës, përgjegjësinë kryesore e mban ministri i Punëve të Jashtme, z. Pacolli. Por, njëkohësisht, janë po aq përgjegjës edhe drejtuesit e Qeverisë dhe të Shtetit të Kosovës, respektivisht kryeministri Haradinaj dhe presidenti Thaçi. Edhe opozita pak po kontribuon sa dhe siç duhet në këtë aspekt.

Konfuzioni në politikën e jashtme dhe amatorizmi në diplomacinë e Kosovës ka nevojë për një mbështetje më të madhe nga shteti shqiptar dhe ekspertët e tij. Me gjithë dobësitë që ka, Shqipëria është shtet i vjetër, ka përballuar pesë luftëra rajonale e botërore, ka ndryshuar shumë sisteme politike e ndërkombëtare dhe është përballur me shumë konjuktura ndërkombëtare pro dhe kundër saj. Shërbimi diplomatik i Shqipërisë ka krijuar një establishment mjaft të mirë dhe të qëndrueshëm karriere. Diplomatët shqiptarë kanë profesionalitet, aftësi dhe përvojë të admirueshme.

Kjo vlerë e madhe e krijuar me mund e sakrifica nga shteti shqiptar është një aset që mund të vihet më mirë në shërbim të Kosovës. Përgjegjësia është e dyanshme. Shteti shqiptar dhe ekspertët e tij nevojitet të kontribuojë më shumë për politikën e jashtme dhe diplomacinë e Kosovës. Nga ana tjetër, lidershipi i Kosovës lypet të jetë më modest e të zhvishet nga euforia dhe egoizmi, që herë-herë kanë marrë trajtën e shpërfilljes, madje edhe të fyerjes së përpjekjeve të shtetit dhe të ekspertizës së tij për ta ndihmuar Kosovën.

Kosova e vetme është e dobët në sistemin ndërkombëtar multilateral dhe krejt e zhbalancuar përkundrejt Serbisë në nivelin bilateral. Në kushtet e kësaj situate ndërkombëtare dhe të kësaj zhbalance forcash Kosovë - Serbi nuk mund të ketë kurrë negociata normale që do të prodhonin rezultat pa humbës. Ndërsa bashkëpunimi aktiv dhe profesional Kosovë - Shqipëri në politikën e jashtme dhe diplomaci do të mund ta përmirësonte ndjeshëm pozitën ndërkombëtare e multilaterale të Kosovës dhe do ta ndryshonte dukshëm balancën bilaterale të saj me Serbinë.

Situata konfuze e politikës së jashtme dhe mefshtësia dhe dilentantizmi i diplomacisë së Kosovës mund të përkeqësohen edhe më shumë në të ardhmen, duke sjellë pasoja më të rënda në marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit të Kosovës. Konstitucionalizmi, institucionalizmi dhe bashkëpunimi duhet t'i zënë vendin konfuzionit dhe konfrontimit në politikën e jashtme të Kosovës. Ndërkohë meritokracia, profesionalizmi, arsimimi dhe përvoja duhet t'i zënë vendin nepotizmit, politizimit dhe partizimit të sëmurë të stafit diplomatik në Ministrinë e Jashtme dhe jashtë vendit. Nevojitet një ndryshim i shpejtë dhe radikal i gjendjes për daljen nga ky kolaps politiko-diplomatik, me qëllim që të parandalohen hapat prapa në ecurinë e njohjeve ndërkombëtare të Kosovës, në procesin e integrimit në organizatat rajonale dhe universale, si dhe në përballjen sfidante të negociatave me Serbinë.

## 3. Situata e brendshme e rendit dhe ligjit në Kosovë

Politika e jashtme dhe diplomacia janë pjesë e politikave publike dhe interesave shtetërore të Kosovës, të shtrira në marrëdhënie ndërkombëtare. Për këtë arsye zhvillimet e brendshme në Kosovë kanë impakt të madh dhe të drejtpërdrejtë edhe në performancën e politikës së saj të jashtme dhe të efektivitetit të diplomacisë së Kosovës.

Ndonëse ka një farë makrostabiliteti të saj, Kosova po demonstron aktualisht situatë jo të kënaqshme të sundimit të ligjit dhe të rendit. Krimi i organizuar, trafiqet e paligjshme, cenimi i rendit publik dhe mosadresimi nga drejtësia vendëse dhe ndërkombëtare i akuzave për krime lufte kanë cenuar rëndë imazhin ndërkombëtar të Kosovës dhe të udhëheqjes së saj.

Është pikërisht kjo situatë që ka ndikuar edhe në vonesën e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës në hapësirën Shengen, por edhe në mjediset e Interpolit për refuzimin e pranimit të saj në këtë organizatë. Situata problematike e sundimit të ligjit dhe rendit në Kosovë dhe sfida e adresimit të ballafaqimit me drejtësinë vendëse dhe ndërkombëtare të krimeve të luftës dhe të pas luftës janë përdorur dhe po përdoren si argumente kryesore nga diplomacia serbe dhe aleatët e saj të dukshëm dhe të padukshëm në qarqet evropiane të Shengenit dhe në Asamblenë e Interpolit, sikundër edhe në mjedise të tjera ndërkombëtare.

Dështimet e Kosovës në UNESCO disa vjet më parë dhe në Interpol disa ditë më parë përbëjnë kambana alarmi shumë serioz për shtetin e Kosovës dhe liderët e saj. Në mënyrë të veçantë politika e jashtme dhe diplomacia e Kosovës kanë nevojë për një rishikim tërësor, duke nisur nga strategjia, prioritetet, planet e veprimit, procesi vendimmarrës e deri tek aftësitë diplomatike, implementuese dhe negociuese ndërkombëtare.

Është mbajtur takimi i fundit i Bordit të Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPSL)

# Kosova po merr përsipër angazhimin e plotë për sundimin e ligjit

**Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se tani e tutje mekanizmin koordinues të Bordit të Përbashkët për Sundimin e Ligjit (BPSL) do ta marrë përsipër "Drejtësia 2020", duke sjell një perspektivë të re të pronësisë së plotë dhe përgjegjësisë së plotë për zbatimin e obligimeve institucionale të Kosovës për një sistem të drejtësisë që është efikas, i përgjegjshëm, transparent dhe llogaridhënës**




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Të mërkurën është mbajtur mbledhja e fundit e mekanizmit koordinues e Bordit të Përbashkët për Sundimin e Ligjit (BPSL), në të cilin për vite institucionet e Kosovës dhe partnerët e saj nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, EULEX dhe partnerët zhvillimorë kanë koordinuar punën për avancimin e sistemit të drejtësisë.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se tani e tutje këtë koordinim do ta marrë përsipër 'Drejtësia 2020', duke sjell një perspektivë të re të pronësisë së plotë dhe përgjegjësisë së plotë për zbatimin e obligimeve tona institucionale për një sistem të drejtësisë që është efikas, i përgjegjshëm, transparent dhe llogaridhënës. "Jemi zotuar të gjithë se agjenda 'Drejtësia 2020' do t'ia ndërrojë ritmin e punës institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe për këtë do të punojmë vazhdimisht për ta përmbyllur njëherë e mirë tranzicionin dhe për ta vendosur drejtësinë në një kurs të pakthyeshëm të përparimit, në të cilën do të kenë besim të parezervë qytetarët e Republikës së Kosovës", ka deklaruar Tahiri.

Shefja e Misionit të EULEX-it, Alexandra Papadopoulou, ka vlerësuar përparimin e bërë nga homologët vendës për fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë, duke theksuar rolin e rëndësishëm që BPSL-ja e ka luajtur përgjatë këtyre viteve si një mekanizëm efektiv për ta lehtësuar bashkërendimin në mes të aktorëve kryesorë vendës dhe të BE-së lidhur me çështjet më të rëndësishme, si dhe duke shërbyer si një katalizator për përmirësime në fushat më të rëndësishme.

Shefja e Misionit EULEX-it ka përmendur performancën dhe kapacitetet e rritura të disa institucioneve të caktuara të sundimit të ligjit si Policia e Kosovës, këshillat gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, si dhe Agjencia e Regjistrimit Civil, që në veçanti ka mundësuar tërheqjen graduale të mbështetjes së EULEX-it e, në anën tjetër, mbështetjen në rritje në mjetet alternative të ndihmës. "Pasi në qershorin që shkoi EULEX-i e përfundoi mandatin ekzekutiv të tij për sistemin e drejtësisë të Kosovës dhe në mënyrë progresive është duke i ndryshuar përgjegjësitë e tij për ndërtimin e kapaciteteve në fushat e tjera të rëndësishme të sundimit të ligjit, tani është koha dhe rendi që autoritetet e Kosovës ta marrin përsipër pronësinë e plotë mbi angazhimet për reforma që t'i bëjnë institucionet e tyre më të afta dhe më të qëndrueshme", ka thënë Papadopoulou. Ajo ka përshëndetur fillimin e iniciativës "Drejtësia 2020" të udhëhequr nga ministri i Drejtësisë në bashkëpunim të ngushtë me kryesuesit e këshillave gjyqësore dhe prokuroriale.

Papadopoulou i ka inkurajuar autoritetet e Kosovës që në kuadër të iniciativës "Drejtësia 2020" ta vazhdojnë punën e mirë të bërë së bashku deri më tani nën ombrellën e BPPSL-së, veçanërisht për zbatimin e udhërrëfyesve të BPSL-së për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Panelit për Ankesa të Agjencisë Kosovare të Pronës, Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe Krimeve të Luftës.

Shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka theksuar se raporti i ri për Kosovën, i cili do ta mbulojë periudhën shkurt 2018 deri në janar 2019, është në proces të hartimit dhe shprehu optimizëm se pas analizimit të të gjitha kontributeve, BE-ja do ta ketë mundësinë që prapë të prodhojë një raport tjetër gjithëpërfshirës i cili do t'i ndihmojë Kosovës më tej në rrugën e saj evropiane. Ajo e ka përgëzuar ministrin Tahiri dhe autoritetet e tjera të Kosovës të përfshira, për përpjekjet e vazhdueshme për zbatimin e kritereve të agjendës së reformave evropiane që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, duke theksuar se ajo që mbetet të bëhet në fushën legjislative është miratimi i shpejtë i dispozitave që kanë të bëjnë me suspendimin dhe shkarkimin e zyrtarëve publikë të akuzuar dhe të dënuar përkatësisht për korrupsion.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Blerim Isufaj, e ka informuar bordin rreth procesit të avancimit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale të Kosovës (PSRK) për procesin e rekrutimit të 10 prokurorëve të ri dhe punësimin e stafit mbështetës në të gjitha prokuroritë në Kosovë. Isufaj, gjithashtu, ka theksuar se KPK-ja i ka adresuar të gjitha rekomandimet e raportit për Kosovën 2018 dhe se në sistemin prokurorial ka progres të matshëm.

# Lansohet versioni i përditësuar i Regjistrit të Lejeve dhe Licencave

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit, në bashkëpunim me International Finance Corporation (IFC), pjesë e grupit të Bankës Botërore, në kuadër të projektit "Klima e Investimeve në Kosovë II", e financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, në një konferencë të organizuar të mërkurën, bënë lansimin e versionit të përditësuar të Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave, qëllimi i së cilës është lansimi i versionit të përditësuar të Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave, i cili është një nga obligimet që është përcaktuar me Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.

Ky regjistër ofron informata mbi të gjitha dokumentet lejuese (leje, licenca, certifikata, autorizime etj.) që institucionet qendrore lëshojnë ndaj bizneseve për ta mundësuar veprimin e tyre në të gjitha fushat e ekonomisë. Regjistri përmban informacion rreth 500 dokumente lejuese të lëshuara nga 26 institucione qendrore në 21 fusha të aktivitetit ekonomik, të cilat mund të gjenden në uebfaqen https://lejelicenca.rks-gov.net.

Ky proces synohet të arrihet nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative për kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për ta mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës.




Besnik Tahiri, koordinator Nacional për Reforma Shtetërore, ka thënë se është përkushtim i Qeverisë për reformë strukturore të administratës së shtetit, në të njëjtën kohë edhe në modernizimin dhe thjeshtëzimin e shërbimeve të cilat jepen për qytetarët dhe sektorin privat.

# Reçica thotë se deri në fund të muajit do të miratohet kontrata kolektive



**Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka bërë me dije se deri në fund të këtij muaji do të miratohet kontrata kolektive. Ai i ka informuar deputetët rreth hapave që janë duke i ndërmarrë sa i përket reformës së plotë të sistemit pensional në Kosovë**

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka raportuar të mërkurën para Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me katër pikat e parashtruara nga komisioni, rreth përmbushjes së agjendës legjislative, projeksioneve buxhetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2019, zbatimit të ligjit për personat e dhunuar gjatë luftës, si dhe për reformën e sistemit pensional në Kosovë.

Po ashtu, ministri i ka informuar deputetët e komisionit për veprimet e ndërmarra lidhur me këto pika ku, ndër të tjera, ka përmendur se MPMS-ja po zbaton Ligjin për personat e dhunuar gjatë luftës. Ai tha se procesi për verifikimin dhe njohjen e statusit të kësaj kategorie ka nisur më 5 shkurt të këtij viti dhe ky proces është duke vazhduar. Gjithashtu, Reçica i ka informuar deputetët edhe rreth hapave që janë duke i ndërmarrë sa i përket reformës së plotë të sistemit pensional në Kosovë.

Kryesuesja e komisionit, Besa Baftiu, ka thënë se MPMS-ja si bartëse e buxhetit për skema sociale dhe pensione është ministria me buxhetin më të madh për vitin 2019 pasi, sipas saj, 26 për qind e buxhetit të institucioneve qendrore shkon për MPMS-në. Kurse kreu i MPMS-së, Skender Reçica, ka thënë se në agjendën legjislative kanë paraparë t'i sjellin në Kuvend shtatë projektligje. "Ne kemi identifikuar me kohë dhe filluam plotësimndryshimin e nenit përkatës, shembull pensionisti kontributpagues nuk ka të drejtë për të përfituar kontribut tjetër nga skema që menaxhohet nga MPMS-ja dhe ne erdhëm në përfundim se kjo është një padrejtësi. Për një person të dalë nga lufta do të ishte padrejtësi për të dhe ne e procesuam në Qeveri këtë plotësimndryshim të ligjit, por kjo nuk u rendit në mbledhje të Qeverisë për shkak të implikimeve buxhetore që pamundësuan plotësimndryshimin e ligjit", ka deklaruar Reçica. Ai ka thënë se buxheti tashmë që është në Kuvend për vitin e ardhshëm për MPMS-në planifikohet të jetë 465.8 milionë euro. "Në krahasim me vitin e kaluar, buxheti i MPMS-së planifikohet të rritet për 57 milionë euro apo 14 për qind", është shprehur ai.

Ministri Reçica ka folur edhe për projektligjin unik për sigurime sociale apo fondin për sigurime sociale, i cili, sipas tij, do të bëhet në baza ndërkombëtare në katër shtylla siç janë: pensioni i pleqërisë, pensioni para viteve '99, pensionet e kategorive të dala nga lufta, pensionet e TMK-së dhe lehonat e papuna. "Kemi 22 skema sociale që financohen nga shteti i Kosovës. Kosova nuk ka arritur për të konsoliduar një sistem të sigurimeve sociale. Sigurimi i plotë është baza e një platforme sociale të një vendi ku ka drejtësi sociale të mirëfilltë dhe për këtë arsye ne kemi identifikuar problemet që ballafaqohemi si vend. Ka një mungesë të plotë të sistemit të sigurimeve sociale, ka mungesë të ligjit bazik, ka mosharmonizim të skemës sociale, ka pamjaftueshmëri financiare, ka presion të kërkesave urgjente në përfshirjen e mbrojtjes së skemave sociale dhe ka strukturë joadekuate të administratës", është shprehur ai.

Reçica ka thënë se deri në fund të nëntorit do të miratohet kontrata kolektive. "Deri në fund të këtij muaji do të miratohet kontrata kolektive që do të përmbajë dispozita të cilat do të zbatohen. Brenda muajit nëntor do të jetë një kontratë e cila do të jetë në përputhje me të drejtat e punëtorëve, punëdhënësve, si dhe do të jetë e zbatueshme në terren", ka thënë ai.

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fatmire Kollçaku, ka thënë se moszbatimi i kontratës kolektive është një problem i madh pasi që shumë punëtorë të sektorëve privatë punojnë pa kontratë dhe askush nuk merr përgjegjësi për këtë. Ajo ka kërkuar nga ministri Reçica që sa më shpejt t'u mundësohet pushimi shëndetësor me pagesë personave që janë me sëmundje të kancerit për shkak të nevojës së mjekimit me kimioterapi.

## Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane kërkon të bojkotohen produktet nga Serbia

PRISHTINË, 21 NËNTOR (ER) - "Të indinjuar thellë me lobimin e fundit nga Serbia për mospranimin e Republikës së Kosovës në organizatën për siguri Interpol, kryesia e Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane i fton të gjithë anëtarët e saj që deri më tani kanë investuar në Kosovë, por edhe tërë qytetarët e Republikës së Kosovës, që t'i bojkotojnë të gjitha prodhimet nga Serbia", është thënë në reagimin e Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane. Sipas këtij unioni, masat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës për ngritjen e tasave prej 10 përqindësh për prodhimet serbe duhet të fuqizohen nga të gjithë me bojkot të përgjithshëm të prodhimeve serbe.

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

# Në buxhetin e 2019-s parashihet rritje ekonomike 4.7 për qind

Ministri i Financave, Bedri Hamza, gjatë raportimit për draftbuxhetin e vitit 2019 ka thënë se rritja ekonomike për vitin 2019 do të jetë 4.7 për qind. Sipas tij, të hyrat totale buxhetore pritet të jenë mbi 1 miliard e 400 milionë euro

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 21 nëntor** - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka raportuar të mërkurën para anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ai gjatë raportimit ka shpalosur draftbuxhetin e vitit 2019, duke theksuar se rritja ekonomike për vitin 2019 do të jetë 4.7 për qind. Hamza ka shtuar se të hyrat totale buxhetore pritet të jenë mbi 1 miliard e 400 milionë euro. "Ky draftbuxhet që është aprovuar nga Qeveria është produkt i nxjerr nga një proces gjithëpërfshirës. Si i tillë, ky draft adreson prioritetet e institucioneve tona për përmirësim të jetës së qytetarëve. Gjatë përgatitjes së këtij draftbuxheti prioritetet për financim janë vendosur sipas prioriteteve. Rritja ekonomike pritet të jetë 4.7 për qind në terma realë. Sa iu përket çmimeve, pritet një stabilitet i theksuar. Projeksionet mbi të hyrat janë të ndërtuara mbi parimet, ndërkaq politikat tatimore do të jenë mbështetëse të sektorit privat, kurse ATK-ja dhe Dogana do të përmirësohen tutje, si dhe do të luftohet informaliteti. Të hyrat totale buxhetore pritet të jenë mbi 1 miliard e 400 milionë euro", ka thënë Hamza, duke shtuar se vetëm nga likuidimi i mjeteve të AKP-së do të jenë 140 milionë euro.

Ai ka folur edhe për planifikimin e shpenzimeve. Sipas tij, rritje të buxhetit do të ketë në të gjitha kategoritë ekonomike, gjithashtu edhe në nivelin lokal. "Duke u bazuar në rritjen e të hyrave, kemi bërë planifikim edhe për shpenzimet. Do të ketë rritje të theksuar në rritjen e kapitalit publik, rritje do të ketë për të gjitha kategoritë ekonomike, po ashtu edhe në nivelin lokal. Kemi rritje të planifikuar mbi shpenzimet rrjedhëse", ka deklaruar ai. Sa i përket deficitit buxhetor, Hamza ka thënë se do të jetë 2 për qind në brutoproduktin vendor, që është i lejuar. "Ky nivel i deficitit do të kombinohet me huamarrje të jashtme dhe të brendshme. Do të ketë huamarrje, por assesi huamarrje që dëmton vendin dhe e fut atë në borxh publik", u shpreh ai.

Ndërkaq kryetari i komisionit, Lumir Abdixhiku, ka thënë se gjysma e buxhetit të Kosovës do të shkojë në skema sociale dhe rroga, kurse ka pohuar se frikësohet që Kosova po shkon drejt një borxhi më të madh publik. "Plani i Qeverisë që e kemi diskutuar në Kuvend është 8 për qind, ndërkaq sot na vjen 4.5 për qind. Jam i shqetësuar për rritjen e borxhit publik në terma realë. Shqetësuese është rritja e shpenzimeve prej 12.5 përqindësh pavarësisht prej rritjes së të hyrave 7 për qind. Pjesa më e madhe e buxhetit është social. 100 milionë euro shkojnë në skemën e veteranëve. Në Kosovë janë 22 skema sociale. Është shqetësuese që 54 për qind e buxhetit shkon në paga dhe skema sociale", ka deklaruar Abdixhiku.



# Gjermania e ndihmon Kosovën me 60 milionë euro grante




**Prishtinë, 21 nëntor (ER)** - Qeveria e Kosovës, e përfaqësuar nga ministri i Financave, Bedri Hamza, dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, e përfaqësuar nga udhëheqës i delegacionit gjerman nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Dirk Schattschneider, kanë zhvilluar diskutime për bashkëpunimin financiar dhe teknik dyvjeçar në mes të dy qeverive. Gjatë takimit u nënshkrua protokolli përmes të cilit Qeveria e Gjermanisë zotoi 60.05 milionë euro grant mbështetje për Kosovën. Mbështetja do të ofrohet për projekte në tre sektorë të ndryshëm siç janë: zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, demokracia, shoqëria civile e administrata publike dhe energjia.

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit, ministri Hamza ka theksuar se Gjermania është një ndër partnerët kryesorë për arritjen e aspiratave të Kosovës për zhvillim ekonomik dhe integrim në Bashkim Evropian, duke shtuar se zotimet për periudhën dyvjeçare do të ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve të Kosovës, për çka ai i falënderoi shumë.

Ndërsa Schattschneider ka thënë se Qeveria e Gjermanisë është krenare që e mbështet Qeverinë e Kosovës në rrugën për Bashkim Evropian dhe është falënderuese për bashkëpunimin shumë të mirë që ka me Ministrinë e Financave dhe institucionet e tjera partnere.

# Prokuroria Themelore e Gjilanit ndalon tre persona për shantazh

Gjilan, 21 nëntor (ER) - Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ndaluar tre persona për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale "Shantazhi". "Ekziston dyshimi i bazuar që të dyshuarit M. K. dhe F. K., gjatë muajit nëntor 2018, në Gjilan, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, kanë shantazhuar të dëmtuarin E. E., në atë mënyrë që nga ai kërkojnë 5 000 euro, në të kundërtën do t'ia publikonin një videoincizim, me të cilin do të dëmtohej nderi dhe autoriteti i tij, pasi që e dyshuara kishte shkuar në ordinancën e të dëmtuarit kinse për t'u kontrolluar, pastaj i ishte afruar duke e prekur në pjesë të ndryshme të trupit", është bërë me dije në njoftimin e kësaj prokurorie. Këta tre persona, sipas Prokurorisë Themelore në Gjilan, me këto veprime kanë kryer veprën penale "Shantazhi" nga neni 341, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).
Ndërsa i dyshuari B. K. me dashje u ka ofruar ndihmë për kryerjen e veprës penale të dyshuarve të sipërshënuar, duke ua dhënë automjetin dhe telefonin e tij, me ç'rast për këto shërbime kishte marrë 100 euro. "Në këtë mënyrë i njëjti ka kryer veprën penale 'Ndihma në kryerjen e veprës penale 'Shantazhi', nga neni 341, paragrafi 1, lidhur me nenin 33 të KPRK-së. Për këtë çështje ndaj tre të dyshuarve është ushtruar kërkesa për caktimin e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh në Gjykatën Themelore në Gjilan", është theksuar në njoftimin për media.






# Konfirmohet zotimi me BERZh-in për investime në projektin 'Qyteti i Gjelbër'

PRISHTINË, 21 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka nënshkruar të mërkurën konfirmimin e zotimit për Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) në emër të Komunës së Prishtinës për Prishtinën "Qytet të Gjelbër". Qëllimi i këtij konfirmimi është rritja e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe BERZh-it për t'i promovuar projektet e veçanta në kuadër të idesë për Qytetet e Gjelbra (Green Cities).
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) do të sigurojë fonde për ta mbuluar koston e këshilltarëve që do ta bëjnë hartimin e planit të veprimit për Qytetin e Gjelbër, këshilltarë të cilët do të angazhohen si ekspertë të fushës përmes rregullave të prokurimit të BERZh-it. Komuna e Prishtinës do të angazhohet për përpilimin dhe zbatimin e këtij plani përmes krijimit të një komiteti drejtues që do të udhëhiqet nga një zyrtar i caktuar komunal, mbledhjes së informacioneve të nevojshme në kohën e duhur dhe caktimit të personave përgjegjës që do të bashkëpunojnë me këshilltarët e angazhuar nga BERZh-i.
Palët do të bashkëpunojnë për përgatitjen, financimin dhe zbatimin e së paku një projekti në vlerë prej 150 milionë euro, që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave të ngurta, ujërat e zeza, ndriçimin publik, transportin urban si dhe efikasitetin e energjisë dhe energjinë e ripërtërishme. Është paraparë që projekti i parë që do të vijë si rezultat i këtij konfirmimi të nënshkruar sot, të jetë "Prishtina Public Building Projekt", që ka të bëjë me masat për efikasitet të energjisë në ndërtesat publike.



# Nënshkruhet kontrata për ndërtimin e çerdhes në fshatin Ratkoc

RAHOVEC, 21 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Lafiti, dhe Jetullah Kabashi, shef i Zyrës së Prokurimit, në prani të drejtorit të Arsimit dhe Rumir Zhuniqit, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, kanë nënshkruar kontratën me Kujtim Thaqin, pronar i NPN "Euroing", e cila do ta bëjë ndërtimin e çerdhes në fshatin Ratkoc. Pas nënshkrimit të kontratës kryetari Latifi është shprehur se një nga zotimet e tij kryesore para qytetarëve ishte se Rahoveci do të bëhet me katër çerdhe të reja. "Në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, nënshkrova kontratën për ndërtimin e çerdhes së re në Ratkoc. Çerdhja në Rahovec është duke u ndërtuar, kurse për vitin tjetër janë në plan edhe çerdhet në Krushë të Madhe dhe Xërxë. Edukimi është e drejtë themelore për fëmijët, kurse për mua dhe qeverisjen time është prioritet", ka potencuar Latifi.

# Shqyrtohet draftrregullorja për tokën bujqësore në Komunën e Malishevës

MALISHEVË, 21 NËNTOR (ER) - Në mbledhjen e dytë të rregullt të Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, që është drejtuar nga kryesuesi i Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Kastriot Berisha, është shqyrtuar draftrregullorja për tokën bujqësore në Komunën e Malishevës dhe listat e përfituesve të subvencioneve për vitin 2018 si dhe disa pika të ndryshme. Ky komitet për këtë draftrregullore pritet të dalë me disa rekomandime dhe plotësime, me idenë që t'ua lehtësojë procedurat qytetarëve në kërkesat për ndërrim, destinim të tokës bujqësore në atë ndërtimore.



# Mësimet që duhen nxjerrë pas votimit në Interpol



Jakup KRASNIQI

Nuk ka asnjë dyshim, mospranimi i Kosovës në Interpol është një dështim i shtetit tonë në përgjithësi dhe i diplomacisë sonë të paaftë e të pagjak në veçanti. Kjo, gjithashtu, është në një formë një disfatë edhe e shteteve me të cilat Kosova e ka koordinuar pavarësinë, pastaj është disfatë edhe për BE-në e cila në gjirin e vet ka shtete që nuk kanë asgjë të përbashkët me vlerat e proklamuara evropiane, siç janë të drejtat e liritë e njeriut, shtetet që edhe në një formë janë mbështetëse të politikave të gjenocidit që i ka ndjekur politika e Millosheviqit dhe që vazhdon t'i ndjekë politika zyrtare e Beogradit edhe sot e gjithë ditën. Pasi edhe këta të sotshmit ishin eksponentë të asaj politike.

E sa për shtetet si Izraeli dhe vende të botës arabe të gjirit dhe të Magrebit, të botës islame aziatike (të Azisë Qendrore e ato të arkipelagut - Malajzi e Indonezi), mbase edhe nuk habitëm pasi që të gjitha që votuan kundër jo vetëm se nuk shquhen për vlera njerëzore e demokratike, për liri e të drejta njerëzore, por janë të njohura për despotizëm e tirani, për krim e gjenocid për të gjithë ata që nuk janë e nuk mendojnë si ata, tiranët, despotët e pashpirt të asaj bote. Ajo botë e ka "kulturë", mbase e ka në gjak, gënjeshtrën, mashtrimin e korrupsionin. Nuk ka më lehtë për Serbinë sesa për të korruptuar atë botë grykëse e mjerane. E vetmja gjë që më habiti janë disa vende si Japonia etj., që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe abstenuan! Kjo, pa dyshim, është paaftësi e diplomacisë sonë për t'i bindur shtetet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës!

Pa marrë parasysh këto që u thanë, institucionet e Kosovës duhet ta nxjerrin nga ky pësim një mësim të mirë. Janë të detyruara ta nxjerrin mësimin se: a ia vlen të vazhdohen bisedimet e Brukselit me Serbinë e pa penduar për gjenocidin që ka ushtruar në Kosovë? Të analizojnë në mënyrë të gjithanshme se a ia vlen që mallrave serbe tu lihen hapur të gjitha dyert e Kosovës, që pastaj Serbia t'i nxjerr miliardat nga parat tona, pastaj i shfrytëzon për të lobuar e korruptuar shtete kundër vendit tonë kudo që i epet rasti, siç ishte edhe rasti i fundit për anëtarësimin në Interpol. Dhe ky rast nuk është i vetmuar! Gjithashtu edhe çështja e dialogut duhet të rishikohet se a duhet biseduar pa fund më një shtet që nuk ka dhënë asnjë shenjë të gatishmërisë as për pendim se jo më për normalizim të marrëdhënieve ndërshtetërore.

Mbase është momenti i duhur që në mbledhjen e dy qeverive shqiptare në Pejë në prag të Nëntorit Kombëtar të bisedojnë më seriozisht se kurrë më parë për Sigurinë Kombëtare se paku për dy dekadat e ardhshme. E kanë ketë përgjegjësi, përgjegjësin për Siguri Kombëtare!

Shkurt, Kosova nuk duhet ngutur e as shfaqur asnjë shenjë dobësie ose të ndonjë interesimi individualist për të vazhduar dialogun në Bruksel, derisa politika zyrtare serbe e ka ketë nivel të lartë armiqësisë ndaj Kosovës e shqiptarëve. Ndërsa masat ndaluese për mallrat serbe duhet ashpërsuar deri në maksimum. Çdo shenjë dobësie e ngutje e shfaqur nga ana e jonë, do të jetë fitore për Serbinë armike. Dhe kjo nuk guxon të ndodhë! Pala e jonë duhet të heq dorë nga gatishmëria e deritashme për të arritur marrëveshje të shpejtë me Serbinë.

Për ketë çështje duhet të arrihet një konsensus nacional dhe pastaj për ketë vendim duhet të njoftohen të gjitha vendet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, e veçmas SHBA dhe BE-ja! Përkundër kësaj, institucionet tona, secili prej tyre duhet t'i marrin përgjegjësit që kanë deri edhe në dorëheqje! Në politikë edhe në atë të interesit duhet që të ketë pak moral! Ajo që u pa dhe u tregua në votimin e Interpolit është se politika nuk është biznes, politika është art tjetër! Nuk mund të them e as besoj se politika e jonë i ka kapacitetet e duhura për të nxjerrë mësimin e duhur.

Nuk ka dyshim, jo vetëm diplomacisë sonë, por gjithë institucioneve të shtetit i duhen energji e koordinim politik si i djelmoshave të kombëtares sonë që e treguan në futboll në dy ndeshjet e fundit! Kosovës i duhet shumë suksesi në fushën politike, por kjo do të jetë e mundur vetëm me një ekip tjetër politik!

Në fund falënderimi im shkon për djelmoshat e futbollit! Suksese!




# Interpoli, dështimi i radhës i shtetit të Kosovës



Lulëzim ETEMAJ

Shteti i Kosovës ka dështuar sot edhe një herë me nismën për t'u anëtarësuar në Interpol. As në raundin e parë dhe as në raundin e dytë nuk ia ka dalë ta sigurojë numrin prej dy të tretave të votave të nevojshme. Për më tepër, 76 votat "për" të votimit të parë, nga 154 vendet pjesëmarrëse në votim (në votimin e dytë rezultati prej 68 votave "për" ishte edhe më i dobët), nuk paraqesin as 50 përqindëshin e votave të pranishme dhe flasin për një debakël të Qeverisë së Kosovës, përkatësisht të diplomacisë së shtetit të Kosovës. Ky dështim do të ketë reflektim negativ të imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Të mos harrojmë, ky është dështimi i katërt me radhë. Herën e parë shteti i Kosovës kërkesën për anëtarësim në Interpol e ka bërë në vitin 2010. Për të dytën herë, në vitin 2015. Kishte dështuar të dy herët që kjo kërkesë të përfshihet në rendin e ditës të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Interpolit. Në vitin 2017, siç ishte komunikuar nga institucionet e vendit, Kosova kishte hequr dorë nga kërkesa me sugjerimin e ShBA-së.

Çfarë ka ndryshuar në kuptimin pozitiv nga viti 2017 që do ta ketë krijuar mendimin apo dhe bindjen tek Qeveria, se tani, një vit më vonë, Kosova ka ecur përpara në aspektin e sigurimit të votave të nevojshme për anëtarësim në Interpol? Kjo është një pyetje në të cilën kryeministri Haradinaj do të duhej përgjigjur publikisht.

Po ashtu është koha që dështimet si ky të adresohen dhe të shoqërohen me masa përkatëse. Në të kundërtën, rrethi vicioz i dështimit të Kosovës do të vazhdojë të mbetet i pa asnjë dalje.

Po t'i marrim parasysh njohjet e shtetit të Kosovës, ka ngecje. Nuk ka ngritje. Madje ka edhe tërheqje të njohjeve paraprake. Procesi i liberalizimit të vizave, aktualisht duket se ka hyrë në qorrsokak. Dhe, dialogu me Serbinë, sado që në fazën finale, ka stagnim. Stagnimit mbi të gjitha i ka shërbyer dhe i shërben edhe më tej edhe mungesa totale e platformës, mungesa e konsensusit politik dhe Ekipit Negociator të shtetit të Kosovës. Fatura në këtë rast shkon në të dy adresat: të pozitës dhe atë të opozitës.

Aktualit shtetit të Kosovës i funksionon vetëm diplomacia e jashtme e presidentit Thaçi. Mungesa e konsensusit politik të Kosovës për dialogun, e vë në pikëpyetje dhe mund ta minojë edhe diplomacinë e tij.

Shteti i Kosovës aktualisht gjendet në ngërç. Posaçërisht në terrenin ndërkombëtar. Me këtë ngërç dhe logjikë skajshmërisht individualiste dhe partiake të liderëve të partive politike dhe institucioneve të shtetit, liberalizimi i vizave, pra fundi i karantinës së Kosovës dhe qytetarëve të saj, jo që s'do të ndodhë këtë vit, por do jetë vështirë i përllogaritshëm.

Kosova e ka fituar lirinë dhe është bërë shtet jo si rezultat i fitores vetjake ndaj Serbisë, por si rezultat i përpjekjeve, sakrificave, luftës çlirimtare dhe bashkërendimit me përkrahësit euroamerikanë. Përderisa në planin ndërkombëtar nuk ka gjasa të arrijë pothuajse asnjë gjë pa mbështetjen e tyre, në planin e brendshëm i duhet të rishqyrtojë me ngutësi të gjitha mekanizmat veprues në raport direkt me Serbinë, në mënyrë që t'i bëhet e ditur se për çdo pengesë në anëtarësim në mekanizmat ndërkombëtare, do të përballet me masa të shumta ndëshkuese, duke filluar nga ato të karakterit ekonomik deri tek ato të fushës së qëndrimit dhe vizitave të zyrtarëve të Serbisë në Kosovë. Në garën e sotme globale për tregje, është plotësisht e pakuptueshme që Serbia të gëzojë edhe më tutje favore në tregjet e shtetit të Kosovës.

Por, krahas shkallës më të lartë të dinjitetit shtetëror, shkathtësisë, guximit dhe kreativitetit ekonomik dhe politik, konsensusi, edhe në këtë rast, është kushti pa të cilin nuk bën dhe nuk mund të ecet përpara.

Në këtë kontekst, shprehja e shqetësimit për mito dhe qasje shantazhuese të Serbisë karshi zyrtarëve të Interpolit dhe të disa delegacioneve të vendeve të caktuara, nuk bën punë madje as për shfryrje të frustrimit personal.

(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /28/

# Të dënuarat e këtij procesi gjyqësor



**Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA**

*(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)*

Pasi se grupi i Halim Spahisë ishte dënuar me vite të mëdha dënimi, një gjë e tillë pritej edhe për atdhetaret e devotshme të Komitetit Nacional Demokratik Shqiptar.

1. E dënuara e parë ishte Laura Shmani, e cila ishte e lindur në Parma, provinca Emilija- Itali. Babai i saj quhej Ugo dhe nëna Luçije, e lindur Furije. Kur u arrestua ishte e moshës 25 vjeçare. Ishte e martuar për Ali Rizën dhe së bashku me të jetonte në Prizren. Me profesion ishte shtëpiake, me kombësi italiane. I takonte besimit katolik. Ishte nënë e një fëmije. Gjendjen ekonomike e kishin të rëndë. Deri në ditën që u arrestua ishte e pa dënuar.

2. Nesibe Zhuri, ishte një aktiviste e madhe e cila ishte angazhuar me shpirt për çështjen e pazgjidhur kombëtare. Në kohën kur u arrestua ishte 17 vjeçe. Ishte e bija e Hysenit dhe nënës Fatime. Ishte e lindur në qytetin e Prizrenit dhe aty jetonte e punonte. Me kombësi shqiptare e besimit mysliman. Në kohën kur u arrestua ishte nxënëse e gjimnazit të qytetit. Ishte e pa martuar dhe e pa dënuar.

3. Gjyljana Mateja, kishte lindur në Prizren, në kohën kur u arrestua ishte 18 vjeçe. Ishte e bija e Tomës dhe nënës Paulinë, e lindur Kola. Me profesion ishte rrobaqepëse, shqiptare me besimin katolik. Ishte e pamartuar, dhe kishte një gjendje të rëndë ekonomike. Deri sa organet e ndjekjes e arrestuan më parë nuk kishte qenë e dënuar.

4. Luqije Bashota në kohën kur u arrestua ishte në moshën 17 vjeçare. E lindur në Prizren, nga babai Luz dhe nëna Mrika, e lindur Luzi. Ishte nxënëse e gjimnazit në qytet dhe ishte shqiptare e besimit katolik. Ishte e pa martuar. Familja e saj kishte një gjendje të mesme ekonomike. Ishte e pa dënuar më parë.

5. Roza Mjeda, ishte e lindur në Prizren nga babai Kristë dhe nëna Çiçile, e lindur Jaku. Në kohën kur u arrestua ishte 18 vjeçe. Merrej me rrobaqepësi. Ishte shqiptare e besimit katolik. Ishte e pa martuar dhe e pa dënuar. Familja e saj kishte një gjendje të mesme ekonomike.

6. Roza Cuki, ishte lindur në qytetin e Prizrenit, nga babai Ndreka dhe nëna Çeçilie e lindur Shahuni. Ishte e moshës 21 vjeçare kur u arrestua. Kryente punët e shtëpisë dhe ishte angazhuar në Komitetin Nacional-Demokratik Shqiptar. Ishte shqiptare dhe kishte besimin katolik. Ishte e pa martuar dhe e pa dënuar. Vinte nga një familje mesatare e kamur.

7. Mane Shyti, e lindur në Katundin e Ri, komuna e Gjakovës nga babai Shyti dhe nëna Gjyle. Në kohën kur iu shqiptua dënimi ajo jetonte në Prizren. Në kohën kur u arrestua Manja ishte 15 vjeçare. Merrej me punë të shtëpisë. Ishte shqiptare e besimit katolik. E pa martuar dhe e pa dënuar deri në ditën e arrestimit. Vinte nga një familje me gjendje të dobët ekonomike.

8. Çeçilija Krasniqi, ishte e lindur në Prizren nga babai Kolë dhe nëna Rozë. Në kohën kur u arrestua ishte 23 vjeçare. Shqiptare e besimit katolik. Me profesion ishte shtëpiake. Ishte e pa martuar dhe e pa dënuar. Familja e Çeçiljes kishte gjendje të rëndë ekonomike.

9. Mrika Gjoka ishte nga Prizreni nga babai Prenga dhe nëna Marije e lindur Marku. Kur u arrestua i kishte 19 vjeç. Merrej me punë të shtëpisë. Ishte shqiptare e besimit katolik. E pa martuar dhe e pa dënuar më parë.

Gjykata Popullore Krahinore më 23 tetor 1945 të gjitha këto i shpalli fajtore, duke i akuzuar se në muajin maj 1945, ato në bashkëpunim me grupin e Halim Spahisë dhe me atdhetarët e tjerë që ndodheshin në arrati, fillimisht ishin anëtarësuar në radhët e NDSH-së, duke dhënë betimin para anëtareve të Komitetit Qendror të NDSH-së, në Prizren, e më vonë kishin formuar Komitetin e femrave të NDSH-së, po në këtë qytet.

Aktiviteti i tyre gjatë këtyre muajve kryesisht ishte përqendruar në atë se ato ishin aktive në mbledhjen e informatave për lëvizjen dhe aktivitetin e ushtrisë jugosllave, duke iu mundësuar atdhetarëve se në çfarë drejtimi dhe në cilat rajone munden me u strehuar dhe ku mund të zhvillonin më sigurt aktivitetin ilegal të tyre. Bile, bile dallohet aktiviteti i pamohueshëm i Laura Shmanit e i Nesibe Zhurit, të cilat në mënyrën më të mençur kanë ditur dhe kanë gjetur rrugët më të përshtatshme për t'u takuar me ilegalen jashtë qytetit, vetëm e vetëm për të përcjell informatat që i kishin mbledh në terren.

Gratë shqiptare që ishin të angazhuara në ilegale në përgjithësi, e në veçanti dalloheshin Laura Shmani, Nesibe Zhuri, Gjuljana Mateja, Luçija Bashota, Roza Mjeda, Roza Cuku dhe shumë të tjera që ishin të organizuara për mbledhjen dhe grumbullimin e ndihmave materiale, po ashtu edhe në sigurimin e armatimit të nevojshëm për ta. Sipas të dhënave që na i ofron aktgjykimi i tyre, thuhej se gjatë kësaj periudhe, ato për Komitetin Qendror të NDSH-së, kishin arritur që të blinin dhe nëpër mes korrierëve t'iu dërgonin tri revole me municion, pesë bomba, një makinë shkrimi, një sasi të madhe sapunë, veshmbathje dhe gjëra të tjera që ishin të domosdoshme për të arratisurit në male.

**Formimi i Komitetit të grave në Prizren**

Grupi i grave të akuzuara, sipas aktgjykimit, thuhej se ato gjatë muajit maj dhe qershor kishin rënë në kontakt me grupet e arratisura në mal, të cilët nuk ishin pajtuar me një status të Kosovës që të ngel nën okupimin serb. Ato, me një vetëdije të lartë kishin marr detyra dhe i kishin kryer ato me përpikëri duke iu ndihmuar atyre me informata të rëndësishme që kishin mbledhur në terren dhe nëpër mes korrierëve i kishin përcjell atyre në mal, por, herë pas here ato edhe vetë kishin shkuar për t'iu dërguar materiale të ndryshme.

Duhet cekur se Laura Shmani, Nesibe Zhuri, Gjyljana Mateja, Luçije Bashota, Roza Mjeda dhe Roza Cuku, në fillim të muajit maj të vitit 1945, ishin takuar me Sefedin Hajredinin, i cili në atë kohë jetonte legalisht në Prizren, por vazhdimisht kishte qenë si lidhje e besueshme e të arratisurve me qendrën dhe me ndihmën e tij ishte formuar Komiteti i Grave të NDSH-së në Prizren.

Pas formimit të Komitetit nga lidhje të caktuara merr vesh se ishte zbuluar për aktivitetin e bërë. Nga qendra merret qëndrimi që ai urgjentisht duhej të largohej nga qyteti dhe të fillojë një jetë ilegale.

Megjithëse kishte ikur Sefedin Hajredini, gratë e angazhuara në Komitet nuk e ndërprenë punën, por përkundrazi aktiviteti i Komitetit çdo ditë e më tepër shtonte aktivitetin. Ato, gjatë veprimtarisë së Komitetit mbajtën shumë mbledhje, në të cilat u diskutonte gjatë e shtruar për situatën politike në Kosovë dhe për okupimin e ri që po e aplikonte Serbia mbi Kosovën.

Në një mbledhje, që ishte e një rëndësie të veçantë, Laura Shmani dhe Nesibe Zhuri kishin folur për organizimin, rëndësinë dhe detyrat e komitetit të grave. Po në këtë takim të gjitha anëtaret e pranishme kishin bërë betimin për besnikëri ndaj komitetit dhe ndaj idealeve të tyre.

Betimi i dhënë para anëtareve kishte këtë tekst :"Betohem në flamurin tonë shqiptar që do të punojmë për lirinë tonë dhe që do të luftojmë në të gjitha anët kundër partizanëve dhe kurrë nuk do e tradhtojmë idenë tonë". Pasi të gjitha në mënyrë solemne japin betimin, po ashtu në këtë mbledhje zgjidhet Këshilli i Komitetit, i cili kishte për detyrë të jepte direktivat për punën e mëtejshme të Komitetit dhe të angazhohej për të mbledhur dhe marr informata për situatën në terren.

Për kryetare të Komitetit ishte zgjedhur Gjulijana Mateja, për sekretare ishte propozuar dhe zgjedhur Luçije Bashota, për arkëtare të Komitetit ishte zgjedhur Nesibe Zhuri, ndërsa Laura Shmani ishte angazhuar që me anën e korrierëve t'i dërgoj materialet e mbledhura të arratisurve në male. Roza Mjeda dhe Roza Cuki ishin angazhuar që në mënyrën më konspirative të grumbullonin informata dhe ndihma të tjera për t'iu dorëzuar Laura Shmanit.

Sipas të dhënave, konstatohej se Nesibe Zhuri, Gjulijana Mateja, Luçije Bashota dhe Roza, qysh në pranverën e vitit 1944, kishin rënë në kontakt me nacionalistët shqiptarë dhe kishin pranuar të punojnë në Organizatën ilegale, ngase për grumbullimin, shpërndarjen dhe organizimin në kushte në çfarë vepronte organizata, më të përshtatshmet ishin gratë, andaj edhe në një mbledhje që kishte mbajtur prof. Ymer Berisha para ilegales, kishte kërkuar që sa më shumë gra të angazhohen në ilegale. Ato me punën e tyre kishin dëshmuar se janë atdhetare të devotshme, dhe se me konsekuencë kryejnë të gjitha punët në të cilat angazhohen. Gjatë kësaj periudhe ato pa u trembur fare nga rreziku që iu kanosej në çdo hap, kishin bërë shumëzimin e materialit propagandistikë, kishin qëndisur flamuj kombëtarë shqiptarë dhe rreth vetes kishin grumbulluar një numër të konsideruar vajzash, të cilat ishin të gatshme që të punonin për organizatën.



FEDERATIVNA NARODNA REPUBLIKA JUGOSLAVIJA
SAVEZNA NARODNA SKUPŠTINA

SAVEZNO IZVRŠNO VEĆE
Pom. br. 1313/54 - 104/54
22 april 1954 god.
Beograd

Na osnovu člana 1 Zakona o davanju amnestije i pomilovanja, tačke 11 člana 79 Ustavnog zakona o osnovama društvenog i političkog uređenja Federativne Narodne Republike Jugoslavije i saveznim organima vlasti i člana 11 Zakona o sprovođenju Ustavnog zakona o osnovama društvenog i političkog uređenja Federativne Narodne Republike Jugoslavije i saveznim organima vlasti — Savezno izvršno veće donelo je

R E Š E N J E

Da se molba za pomilovanje FLJUKA DŽEMILJA, osudjenog pravosnažnom presudom Okružnog suda u Prizrenu K.6/45 od 27 septembra 1945 godine - ODBIJE.

SMRT FAŠIZMU - SLOBODA NARODU !

POTPRETSEDNIK
SAVEZNOG IZVRŠNOG VEĆA,

M.P. A.Ranković s.r.

Da je ovaj ... veran svome originalu tvrdi i overava ... za pomilovanje Saveznog Izvršnog Veća.
načelnik
(Borivoja Živković)

## Dënimet e shqiptuara

Gjykata Popullore, më 23 tetor 1945, të gjitha të lartpërmendurat i akuzonte në bazë të nenit 6 të ligjit mbi fajet kundër popullit dhe shtetit në lidhje me nenin 1, pika 10 e 9 dhe nenit 8, alineja 1, të ligjit mbi llojin e dënimeve dhe ligjit mbi konfiskimin e pasurisë dhe ekzekutimin e konfiskimit.

1. Laura Shmanit iu shqiptua dënimi me humbje lirie prej 5 vitesh burg të rëndë dhe me punë të detyrueshme në vazhdim prej pesë vjetësh. Dënohej me humbjen e të drejtave politike e disa qytetare me përjashtim të tyre prindërore në vazhdim prej 5 vjetësh, aq sa iu kishte llogaritur pas vuajtjes së dënimit dhe me dënim të konfiskimit të një shtëpie në rrugën "Marrshall Tita" në Prizren.

2. E dënuara e dytë ishte Gjulijana Mateja, e cila u dënua me 2 vjet burg, me punim të detyrueshëm në vazhdim prej dy vitesh, me kusht që dënimi t'i llogaritet nga dita e arrestimit, me humbjen e të drejtave politike dhe disa qytetare, përveç asaj prindërore në vazhdim prej tri vitesh, që do t'i llogaritet pas vuajtjes së ndëshkimit.

3. Luçije Bashotës, Gjykata Popullore i shqiptoi dënimin prej një viti burg, me punë të detyrueshme me vazhdim prej një viti, që do t'i llogaritet prej ditës së arrestimit.

4. Edhe Roza Mjedës gjykata i shqiptoi dënimin prej një vitit burg me punë të detyrueshme.

5. Nesibe Zhuri, po ashtu u dënua me një vit burg të rëndë dhe me punë të detyrueshme.

6. Roza Cukit iu shqiptua dënimi prej një viti burg, ku ishte e obligueshme për punë të detyrueshme derisa i zgjatë koha e burgosjes. Ndërsa nga aktakuza u liruan Mane Shyti, Çeçilija Krasniqi, dhe Mrika Gjoka.

Edhe pse u dënuan dhe vuajtën burgun, të gjitha të dënuarat asnjëherë nuk u penduan dhe nuk i treguan shokët me të cilët vepruan ilegalisht. Bile edhe pas daljes nga burgu disa nga ato kishin vazhduar me veprimtari ilegale, siç ishte rasti i Nesibe Zhurit, e cila më vonë u angazhua në organizatën ilegale "Lidhja e Prizrenit", që veproi në Prizren. **(Vijon)**




DOLI NË SHITJE
LIBRI EKSKLUZIV I AUTORIT FATON MEHMETAJ, "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT"

Libri më i ri i studiuesit dhe njohësit të mirë të çështjeve të sigurisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Faton Mehmetaj, "Veprimtaria e shërbimeve sekrete ruse në shtetet e Ballkanit", sjellë të dhëna dhe dëshmi tronditëse mbi shtrirjen dhe veprimtarinë e shërbimeve sekrete ruse në Ballkan.

- Si tentuan shërbimet ruse ta destabilizojnë Kosovën?
- Si tentuan grusht shtetin në Mal të Zi, në Shqipëri e Maqedoni?
- Cilat janë shërbimet ruse që operojnë në Ballkan?
- Cilat janë format dhe metodat e shërbimeve sekrete ruse për të destabilizuar rajonin?
- Cila është strategjia e tyre operuese?
- Si ndikuan këto shërbime nëpërmjet medieve, politikës, ekonomisë, të fuqizojnë politikanë dhe struktura politike për t'i pozicionuar në strukturat më të larta të shteteve të rajonit për të mbrojtur interesat pro-ruse?

Përgjigjet në këto pyetje dhe në shumë e shumë pyetje të tjera i gjeni në librin ekskluziv "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT", një studim hulumtues, i autorit Faton Mehmetaj, i pari i këtij lloji dhe njëherësh ndër librat më të kërkuar nga lexuesit, ku nxirret lakuriq veprimtaria destabilizuese e shërbimeve ruse në rajon. Libri përmban 214 faqe dhe është botim i përbashkët i Institutit për Studime Gjeopolitike dhe Siguri (ISGJS) dhe Gazetës së Përditshme Shqiptare "EPOKA E RE", në Prishtinë.



E jashtëzakonshme

# I merret patentshoferi vetëm 49 minuta pasi e mori



Një adoleshenti i është marrë patentshoferi vetëm 49 minuta pasi e mori, ka njoftuar policia gjermane. 18-vjeçari po kthehej pas testimit të suksesshëm të makinës kur e kapi policia. Ai po ecte me dyfishin e shpejtësisë. Në një zonë ku lejohej 50km/h, adoleshenti po drejtonte mjetin me 95 km/h. "Disa gjëra zgjasin përgjithmonë, të tjerat jo më shumë se për një orë", ka theksuar policia gjermane në një deklaratë për media.

FOTO E DITES



Një fëmijë shihet duke ngrënë në një qendër të personave të zhvendosur në Juba të Sudanit të Jugut. /AP/

E rrallë

# Gjashtë kilogramë plastikë gjenden në stomakun e balenës së ngordhur



Gjashtë kilogramë plastikë u gjetën në stomakun e një balene e cila u gjet e ngordhur në një plazh në Indonezi. Kjo u njoftua nga zyrtari i Parkut Kombëtar Wakatobi, në ishullin e Sulawesi, pasi zbulimi ndodhi të hënën në mbrëmje. Balena, 9.5 metra e gjatë, kishte brenda një masë plastike të përbërë nga 115 gota, katër shishe, 25 çanta najloni dhe sandale.

## BARSOLETA E DITËS



**Plaku: Ti djalë, a po ma lëshon karrigen, se më mbytën këmbët?!**
**Djali: Axhë, kur je kanë ti i vogël, a ia ke lëshu ndokujt vendin?**
**Plaku: Po, vallahi, gjithë.**
**Djali: Prandaj s'po mund të rrish në këmbë.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### "ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

**Vetem gjate vikendit në ora 14:00**







Në ora 16:00

### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

**Rolet:** Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
**Regjia:** David Kerr

Në ora 18:00

### "NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
**Regjia:** Malcolm D. Lee







Në ora 20:00

### "SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
**Regjia:** Matthew Ross

Në ora 22:00

### "VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

**Rolet:** Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Me altruizmin që ju karakterizon do të zgjidhni punë mjaft shpejt me një të lindur të shenjës së Shigjetarit.



**DEMI**
Me ngarkesën që keni kohën e fundit ju duhet një vend i qetë për të pushuar. Përzgjidhini ato vende që i pëlqeni.



**BINJAKËT**
Sot vetmia ju ka mposhtur dhe çdo moment po e shihni gotën gjysmë të zbrazët. Në ditë të tilla është mirë të qëndroni vetëm me njerëz ekspresivë.



**GAFORRJA**
Romanticizmi juaj tipik sot do të marrë krahë dhe do ta prekë zemrën e partnerit. Ndiheni të mbushur me energji të mirë këto ditë.



**LUANI**
Keni filluar t'i l logarisni shumë gjërat që do të bëni në të ardhmen. Duke bërë kaq shumë plane nuk po shijoni spontanitetin e ditës.



**VIRGJËRESHA**
Përvoja është një vlerë e shtuar që ju lejon të jeni më të sigurt në hapat që hidhni dhe të mos rrezikoni aty ku mendoni që ka diçka.



**PESHORJA**
Sot do të eksploroni ambiente të reja me të cilat mbase do të jeni shumë të lidhur pak më vonë. Ndjesia e të resë ju shoqëron dhe ju jep shpresa.



**AKREPI**
Po bëni bilancin e ngjarjeve të fundit dhe doni të shikoni se ku keni arritur me investimet që keni bërë si në fushën e ndjenjave dhe në atë financiare.



**SHIGJETARI**
Sot do të jeni ju iniciatorët e një udhëtimi me miqtë që në fund të ditës do t'ju kënaqë të gjithëve. Ideja juaj do të vlerësohet.



**BRICJAPI**
Jeni në një pikë mjaft pozitive për jetën tuaj, por drejtimi që do të merrni mund të lëkundet nga një situatë disi dramatike.



**UJORI**
Po e përballoni mjaft mirë fluksin e punës. Edhe pse mund t'ju duken të pazgjidhshme për momentin, do t'i rregulloni më pas ato që po i lini anash.



**PESHQIT**
Jeni disi nën presion për një çështje të caktuar dhe kjo gjë ju ka bërë nervoz me ata persona që ju gjenden pranë.

# Cardi B realizon ëndrrën e fëmijërisë



Ëndrrat e Cardi B dhe nënës së saj janë plotësuar. Reperja 26-vjeçare i bleu nënës së vet një shtëpi të mrekullueshme dhe lajmin e ndau me fansat. "Gjithmonë kam pasur ëndërr t'ia blej nënës sime një shtëpi. Vitin e kaluar kam qenë aq e etur për t'ia blerë një shtëpi, por nuk kisha mundësi. Unë punova, punova dhe tani kam këtë"', dëgjohet duke thënë në një video të publikuar në rrjetet sociale Cardi B.

# Nicole Scherzinger i bashkohet UNIFEC-it në ndihmë të fëmijëve në nevojë



UNICEF-i ka ndërmarrë një nismë për fëmijët në nevojë. Në Ditën Botërore të Fëmijëve organizatës iu bashkua edhe këngëtarja e famshme, Nicole Scherzinger. Ajo kaloi kohët me fëmijët dhe shfaqet e buzëqeshur me ta, duke i përcjellë energji dhe pozitivitet. "Sot është Dita Botërore e Fëmijëve. Këtë ditë kam vendosur ta festoj me fëmijët në vende të ndryshme të botës. Jam shumë me fat që po punoj me UNICEF-in", ka shkruar ajo në "Instagram".




# Katy Perry shpallet gruaja më e paguar në industrinë e muzikës

Revista "Forbes" ka shpallur këngëtaren Katy Perry gruan për të paguar të vitit 2018 në industrinë e muzikës. Revista e biznesit vlerëson se Perry fitoi 83 milionë dollarë nga qershori i vitit 2017 deri në qershor të këtij viti. Gjatë kësaj kohe ajo ka performuar 80 ditë në turneun e saj botëror për promovimin e albumit të pestë, Witness, duke fituar më shumë se 1 milion dollarë në një natë.

# Kanye West dhuron 500 mijë dollarë për fondin e Kalifornisë Fire Relief



Reperi me famë botërore, Kanye West, ka dhuruar 500 mijë dollarë për fondin e zjarrit në Kaliforni Fire Relief, pas zjarrit që kohën e fundit kapi qytetin. 41-vjeçari, i cili punësoi zjarrfikës privat për ta mbrojtur pallatin e vet prej 60 milionë dollarësh, thuhet se ka dashur të ndihmojë të kontribuojë për rindërtimin e komunitetit. Sipas "TMZ"-së, këto i tregon gruaja e reperit Kim Kardashian në shoun televiziv "Ellen DeGeneres". Ajo tregoi se çifti kishte një "diskutim serioz" se si ta ndihmonte komunitetin dhe se Kayne po dilte me një plan veprimi.

## Merkeli do ta mbështesë marrëveshjen e Brexitit



BERLIN, 21 NËNTOR - Gjermania do të mbështesë marrëveshjen e tërheqjes së Britanisë nga Bashkimi Evropian, duke shpresuar se do të zgjidhjet edhe çështja e Gjibraltarit, territorit të kontestuar britanik, tha kancelarja gjermane Angela Merkel. Kryeministri i Spanjës, Pedro Sanchez, tha të martën se qeveria e tij do të votojë kundër marrëveshjes së Brexit-it, nëse përmbajtja për Gjibraltarin nuk ndryshon në tekst.
Gjibraltari parashihet të largohet nga Bashkimi Evropian së bashku me Mbretërinë e Bashkuar në mars, pavarësisht referendumit më 2016 që rezultoi me qëndrim në bllok. "E dimë se sa të vështira janë bërë diskutimet në Britani, por mund të them se Gjermania do të pajtohet me marrëveshjen e Brexit-it, tha Merkeli para deputetëve. "Ende kemi dyshime për Spanjën. Nuk e di se si do të zgjidhjet kjo çështje, por shpresoj se do të zgjidhjet të dielën", tha ajo.
Bashkimi Evropian pritet të mbajë një samit të dielën për të diskutuar të ardhmen e Britanisë.

# Vazhdon beteja për ekstradimin e Nikolla Gruevskit

**Ministrja maqedonase e Drejtësisë, Renata Deskoska, ka thënë se kërkesa për ekstradimin e ish-kryeministrit Nikolla Gruevski duhet të pranohet meqë ajo është e bazuar në fakte të qëndrueshme juridike**



SHKUP, 21 NËNTOR - Institucionet e Maqedonisë presin që kërkesa për ekstradimin e ish-kryeministrit Nikolla Gruevski të pranohet meqë, sipas ministres së Drejtësisë, Renata Deskoska, ajo është e bazuar në fakte të qëndrueshme juridike. Deklarata e tillë vjen pas njoftimit të ish-kryeministrit se autoritetet hungareze kanë pranuar kërkesën e tij për azil politik të bazuar në, siç ka thënë, kërcënimet për jetën e tij, politizimin e sistemit të drejtësisë, e çështje të tjera të theksuara në profilin e tij në "Facebook". "Kërkesa për ekstradim është e arsyetuar me të gjitha argumentet e mundshme dhe nëse vendoset në bazë të procedurave juridike, ajo duhet të pranohet. Me Hungarinë edhe më parë kemi pasur bashkëpunim në raste të tjera të ekstradimit dhe nuk besojmë se ky do të jetë rasti i parë që do të refuzohet", tha ajo. "Duke marrë parasysh gjithë procesin e arratisjes së Gruevskit dhe mbërritjes së tij në Budapest, shohim se kemi të bëjmë me përzierje të politikës, por ne si shtet do t'i shfrytëzojmë të gjitha argumentet juridike dhe presim që shtetet anëtare të BE-së të veprojnë sipas politikave të tyre evropiane", ka deklaruar Deskoska duke lënë të hapur mundësinë që institucionet e tjera të Hungarisë t'i anulojnë dhënien e azilit Gruevskit, por edhe një fakt tjetër që sipas saj bazohet në të drejtën e shtetësisë. "Nëse vendimi për azil është bazuar në fakte të cilat nuk janë ashtu siç duhet të jenë, atëherë shteti ka të drejtë të tërheqë vendimin apo ta anulojë. Nëse marrin parasysh ligjet hungareze, ata që fitojnë azil nëse në të njëjtën kohë nuk fitojnë edhe shtetësi hungareze apo vendqëndrim të përhershëm, vendimi për azil shqyrtohet me automatizëm në çdo tre vjet. Pra, nëse Gruevski nuk fiton shtetësi, azili i tij mund të shqyrtohet pas tre vjetëve", ka deklaruar Deskoska duke hedhur poshtë arsyetimet e Gruevskit për kërcënime për jetën e tij, por edhe pretendimet tjera për pasiguri në Maqedoni.
Por, bazuar në një prononcim të ministrit hungarez të Drejtësisë, Lazlo Troshani, të cilën e transmetojnë mediet në Shkup, ekstradim të Grueskit nuk do të ketë pasi ai tashmë ka fituar të drejtën e azilit në Hungari. Troshani citohet të ketë thënë se "me atë që i është miratuar kërkesa për azil, Hungaria ka pranuar se Gruevski është viktimë e ndjekjes dhe se nuk mund të ekstradohet". "Të jemi të sinqertë, nëse ish-kryeministri shkon në burg, sigurisht se nuk do ta ketë të lehtë", ka deklaruar ministri hungarez i Drejtësisë.
Por, pavarësisht kësaj, institucionet e Maqedonisë thonë se tashmë rasti me Gruevskin është problem edhe evropian pasi kur një vend anëtar i BE-së merr në mbrojtje një person të dënuar për shpërdorim të detyrës, atëherë paraqet problem serioz që vë në pikëpyetje sundimin e së drejtës në vetë Bashkimin Evropian. "Ky është problem për Maqedoninë, por problem edhe për Bashkimin Evropian si dhe kredibilitetin e sundimit të së drejtës në Bashkimin Evropian..Gjykimi kundër tij ishte ndjekur nga OSBE-ja dhe përfaqësues të BE-së dhe asnjëherë nuk kemi pranuar ankesa. Edhe Departamenti amerikan i Shtetit procesin e kishte vlerësuar si fer dhe transparent. MPB-ja gjithashtu nuk kishte pranuar asnjë ankesë se ndaj tij ka kërcënime për jetën. Gruevski kishte gjashtë pjesëtarë të sigurimit të zgjedhur nga vetë ai", ka deklaruar Ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov.
Ndërkohë, pas arratisjes së ish-kryeministrit dhe njoftimit të fitimit të drejtës së azilit politik, organet e rendit të martën në mbrëmje kanë arrestuar Sasho Mijallkovin, ish-drejtorin e Policisë sekrete, njëherësh familjar i Nikolla Gruevskit, i cili gjithashtu po gjykohet në disa procese gjyqësore për shpërdorim të detyrës zyrtare.

## Kim Jong Yang, president i ri i Interpolit



DUBAI, 21 NËNTOR - Interpol-i zgjodhi të mërkurën Kim Jong Yang nga Koreja e Jugut në postin e presidentit të agjencisë, duke hedhur poshtë kandidaturën e Rusisë që nxiti shqetësime në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara për rrezikun e ndërhyrjeve ruse.
Agjencia me 194 anëtarë zgjodhi në kongresin vjetor në Dubai që Kim të trashëgojë në këtë post kinezin, Meng Hongwei, i cili u zhduk në muajin shtator dhe më pas dha dorëheqje, pasi që autoritetet kineze thanë se po e hetojnë atë nën dyshimet për korrupsion.
Interpol-i njoftoi se Kim që shërbente si ushtrues detyre i presidentit, u zgjodh për një mandat dyvjeçar. Nestor R. Roncaglia nga Argjentina, u zgjodh si nënpresident për një mandat trevjeçar.
Kandidatura e Alexander Prokopchuk nga Rusia, një gjeneralmajor i policisë dhe një nga katër nënpresidentët e Interpol-it, kishte nxitur shqetësime në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara për mundësinë që Rusia të keqpërdorë fuqinë e Interpolit.
Një grup dypartiak senatorësh amerikanë i shkroi Interpolit që ta paralajmërojë kundër emërimit të kandidatit rus Prokopchuk, duke e krahasuar me "futjen e një dhelpre në kotec pulash".
Kremlini tha të martën se ky qëndrim paraqet përzierje në zgjedhjet në Interpol.
Në Evropë, ish-kryeministri belg, Guy Verhofstadt, njëherësh anëtar i Parlamentit Evropian, tha se "vendet e lira dhe demokratike mbase duhet të mendojnë për një organizatë paralele", nëse zgjidhet rusi Prokopchuk.

# "Smartphone" i thyer ose i vjetër? 7 këshilla për bërë (gati) si të ri

Nga përditësimi i sistemit dhe i aplikacioneve, pastrimi i kujtesës, deri te pajisja e restaurimit të plotë. Dhe për dëmtime estetike ju mund të përdorni mbrojtëse 'cover'-i



"Smartphone" i vjetruar shumë dhe çfarë duhet të bëni? Nëse kemi një "smartphone" për një kohë të gjatë, mund të fillojmë të përjetojmë probleme tepër të bezdisshme, nëse është e ashtuquajtura vjetërsi e planifikuar ose koha e nevojshme për zëvendësim. Bateria shkarkohet shpejt, ka hapësirë të vogël në kujtesë, aplikime jo të pajtueshme dhe mungesë rrjedhshmërie në aktivitetet normale që ndodhin çdo ditë, duke e bërë të vështirë të përdorësh këtë pajisje. Një pajisje mesatare ose më e lartë zakonisht ka një cikël jetësor të performancës maksimale që zgjat rreth 4 vjet dhe sigurisht do të tregojë shenjat e para të plakjes. A mund t'i zgjidhim këto probleme dhe të "restaurojmë" një "smartphone" të vjetruar?
Nëse jeni në këtë situatë përpiquni të ndiqni sugjerimet në këtë udhëzues dhe do të vini re përmirësime, jo vetëm në performancë.

## Sistemi operativ

Duke përdorur një version të vjetruar të sistemit operativ, qoftë iOS apo Android, ekspozon stabilitetin dhe sigurinë si dhe është e rrezikshme për parandalimin e ekzekutimit korrekt të aplikacioneve të fundit. Një nga hapat paraprakë për të optimizuar një pajisje të vjetër është të kontrolloni për përditësimet e reja në dispozicion.
Për të kontrolluar për një version të iOS që ende nuk është i instaluar, hapni cilësimet e iPhone dhe shkoni te Të përgjithshmet – Përditësimi i softuerit: nëse pajisja është e lidhur në mënyrë korrekte me një rrjet pa wireless, do të duhet disa sekonda për të ditur nëse ka një përditësim që pret të instalohet. Duke prekur Shkarko dhe instalo, do të fillojmë të përditësojmë.
Në pajisjet Android procedura paraqet disa dallime në bazë të markës. Në përgjithësi shkojmë te Settings, pastaj shkojmë te Device Info dhe më në fund Updates Software: nëse ka një version të ri, e shkarkojmë dhe e instalojmë atë. Para përditësimit të sistemit operativ, gjithmonë është e këshillueshme që të bëni një kopje të plotë të të gjitha të dhënave të ruajtura në "smartphone"; gjithashtu mos harroni të lini pajisjen në karikim gjatë azhurnimit dhe mos e ndërprisni atë për ndonjë arsye.

## Aplikimet

Ç'instaloni aplikacionet e padobishme dhe përditësoni pjesën tjetër me versionet e fundit të lëshuara: kështu si për sistemin operativ, edhe aplikacionet e përditësuara ndikojnë në performancën e pajisjes.
Për të çinstaluar një aplikacion në iOS, vendosni një gisht në ikonën e një aplikacioni dhe prekni "X" që shfaqet në pjesën e sipërme të majtë pas disa sekondash; nëse keni një telefon Android, mbani presionin mbi një ikonë të aplikacionit dhe tërhiqeni atë në artikullin Uninstall që shfaqet në krye. Duke hequr elementet e padobishme, ne vazhdojmë të përditësojmë aplikacionet e mbetura që mund të kandidoni në iPhone duke hapur dyqanin e App, duke shtypur skedën Updates dhe duke zgjedhur artikullin blu Update all; në "smartphone" Android, nisim me Play Store dhe pastaj hyjmë në menynë duke trokitur ikonën me tre vija vertikale që shfaqen në pjesën e sipërme të majtë: zgjedhim aplikacionet e mia dhe fillojmë shkarkimin e të gjitha përditësimeve në dispozicion duke prekur butonin e gjelbër Update all.

## Hapësira e magazinimit

Duke zgjedhur aplikacionet për të mbajtur në pajisje, ne do të kemi kryer pjesërisht aktivitetin e zbrazjes së kujtesës nga skedarët e padobishëm. Ne kontrollojmë seksionet e përdorimit ose kujtesës se sa hapësirë është akoma në dispozicion në kujtesën e telefonit dhe cilat lloje të skedarëve po zënë hapësirë.
Fotografitë, videot, të dhënat e navigimit, aplikacionet, mesazhet dhe mesazhet zanore të WhatsApp, rriten vazhdimisht kur përdorim pajisjen për aktivitetet e përditshme: nëse nuk e kemi rivendosur "smartphone", është e lehtë të gjesh kujtesën e ngopur dhe një telefon të ngadalshëm për të luajtur operacionet.
Përpiquni me durim, hiqni përmbajtjen e panevojshme nga pajisja juaj, si fotot ose videot me cilësi të ulët, pastroni historinë tuaj të shfletuesit dhe fshini bisedat WhatsApp që nuk na interesojnë. Një gjë e mirë është të lini vazhdimisht të lirë 20% të kujtesës totale të instaluar.

## Rivendos pajisjen

Një zgjidhje drastike, por efektive për të shpejtuar një "smartphone" është që të kryeni një rivendosje të fabrikës, në terma IT, formatimin dhe riinstalimin e sistemit operativ. Duke kryer një rivendosje të plotë, cilësimet do të rivendosen dhe do të hiqen të gjitha të dhënat e ruajtura: sistemi operativ i "smartphone"-it do të jetë i pastër, siç e kemi konfiguruar për herë të parë pas blerjes së tij.
Për të inicializuar një iPhone, shkoni te Settings – General – Restore dhe përfundoni operacionin duke zgjedhur "Initialize content and settings". Me Android, në mënyrë të ngjashme, hapim Settings dhe pastaj shkojmë te "Backup and Restore" dhe më në fund Restore Factory Data (ose Reset Device), dhe pastaj konfirmojmë fshirjen e të dhënave për të finalizuar operacionin.
Edhe në këtë rast, kopjimi është një operacion themelor për t'u kryer përpara se të bëhet rivendosja në mënyrë që të shmangen humbjet e pakthyeshme të galerisë, shënimeve, kontakteve, kalendarëve dhe të gjitha të dhënave të ruajtura në "smartphone".

## Bateria

Komponenti i një "smartphone" që tenton të përkeqësohet më shpejt dhe pa rrugëdalje, është bateria. Në varësi të përdorimit që bëjmë, autonomia e telefonit mund të ulet pak a shumë shpejt, derisa të arrijë një kohëzgjatje shumë të shkurtër kur ka nevojë për një zëvendësim.
Një bateri e përdorur nga më shumë se dy vjet me siguri duhet të zëvendësohet nëse "smartphone" juaj nuk arrin në fund të ditës me një karikim minimal të mbetur, por për t'i vlerësuar këto të dhëna me saktësi, mund të përfitojmë nga funksioni i gjendjes së baterisë në seksionin Settings – Battery të iPhone që tregon qartë përqindjen e kapacitetit maksimal të baterisë së instaluar në pajisje. Edhe me Android mund të bëjmë një matje të ngjashme duke shkarkuar aplikacionin falas AccuBattery të disponueshëm në dyqanin Play: pas fillimit, një tregues në ekranin kryesor do të na tregojë statusin e kapacitetit. Një bateri me një kapacitet të mbetur maksimal prej më pak se 60% duhet të zëvendësohet shpejt

## Ekrani

Nëse performancat e përmirësuara nuk janë të mjaftueshme për të ndaluar dëshirën për të ndryshuar "smartphone", duhet të hedhim një vështrim në pamjen estetike të pajisjes: të lundrosh në internet ose të shikosh një video, duke u penguar nga krisjet dhe dëmtimet në ekran, nuk është fare e këndshme.
Nëse ato që e shkatërrojnë estetikën janë vetëm disa gërvishtje të vogla ose një zbutje e lehtë e xhamit, mënyra më e mirë për të rregulluar këtë siklet përfshin aplikimin e një xhami të mbrojtur, të cilën ne mund të blejmë me disa euro. Duke siguruar që ne të gjejmë formatin e duhur për telefonin që posedojmë, pastrojmë me kujdes sipërfaqen e ekranit dhe aplikojmë mbrojtjen, duke u siguruar që të ndreqim me saktësi vijat e qelqit me sensorin e kamerës së përparme, sensorët dhe ndoshta tastin Home, nëse përdorim një iPhone të vjetër.

## Trupi

Dhe së fundi, prekja përfundimtare është në zarfin që përmban të gjitha komponentët e "smartphone"-it: trupi. E ekspozuar vazhdimisht ndaj goditjeve, objekteve të hapura dhe motit të keq, pavarësisht se është ndërtuar me materiale të qëndrueshme, krijon shenja të dukshme, sidomos nëse nuk përdorim mbrojtës.
Duke shmangur produktet antizero që shpesh mund të lyejnë ose njollosin pajisjen, e pastrojmë me një letër të lagur që përdorim për ekranet LCD dhe fshehim papërsosmëritë me dy zgjidhje të ndryshme: një shtresë ngjitëse ose një mbulesë. Ka shumë lloje ngjitësish në treg për të mbuluar "smartphone", duke u dhënë atyre një pamje krejt tjetër: fibër karboni, dru, efekt metali ose njerëz të famshëm, ka kaq shumë për të gjitha shijet; ato janë një zgjidhje e përshtatshme, sepse nuk ndryshojnë madhësinë dhe masën e pajisjes në një mënyrë të qartë, por për fat të keq trashësia e reduktuar nuk garanton mbrojtje në rast të rënies së dhunshme.
Nga ana tjetër, kapakët, të disponueshëm në shumë modele dhe materiale, mund të mbulojnë dëmtimin e trupit dhe ta mbrojnë atë nga goditjet shumë mirë: ne mund të zgjedhim një zgjidhje transparente që do të ishte e shkëlqyeshme për t'i dhënë dritë një trupi të errët.

*(gazeta-Shqip.com)*




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | BAHIA - FLUMINENSE | 1&3+ | CEARA - PARANA | 1 | AL WEHDA - AL BATEN | 1 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Sahiti: Synimi i Kosovës, Evropiani

Muharrem Sahiti për "Epokën e re" ka thënë se kualifikimi në "play-off" të Ligës së Kombeve është një sukses i madh për futbollin e Kosovës, por synimi kryesor është kualifikimi në Kampionatin Evropian. "Kemi kohë deri te përballja me Maqedoninë që zhvillohet në mars të vitit 2020. Deri atëherë mund të bëhemi skuadër edhe më e mirë dhe normalisht pritet të ketë prurje të reja të futbollistëve. Maqedonia është kundërshtare e fortë, por synimi ynë është kualifikimi në Evropian", ka thënë Sahiti



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka arritur një sukses të madh, i cili po vlerësohet historik për sportin e Kosovës, për faktin se rruga drejt kualifikimit në Kampionatin Evropian është shkurtuar shumë. "Dardanët" arritën të dalin të parët në grupin e tretë të Ligës D në Ligën e Kombeve dhe me dy fitore në gjysmëfinale dhe finale do ta siguronin realizimin e kësaj ëndrre.

Muharrem Sahiti, i cili që një kohë të gjatë është pjesë e përfaqësueses në rolin e ndihmëstrajnerit, ka thënë të mërkurën për "Epokën e re" se ky rrugëtim nuk ka qenë aspak i lehtë për Kosovën. "Ka qenë rrugëtim aspak i lehtë për Kosovën, që është skuadër e re, por arritëm të tregojmë performancë të mirë në Ligën e Kombeve dhe të arrijmë një sukses të madh. Ishim në një grup të vështirë, pasi Azerbajxhani vlerësohej favorit i madh, por ne iu kemi qasur me seriozitet të madh dhe pas barazimit si mysafir i kësaj përfaqësuese, u motivuam edhe më shumë për të arritur sukses, derisa në ndeshjen e fundit kemi qenë të bindur se do të dalim të suksesshëm, për faktin se kishim në opsion fitoren dhe barazimin. Ky është një sukses i madh, por jemi të vendosur që të qëndrojmë me këmbë në tokë dhe të vazhdojmë këtë rrugëtim", ka thënë Sahiti.

Trajneri Muharrem Sahiti ia ka atribuuar këto suksese ish-kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri. Sipas tij, legjenda e futbollit është personi që bëri revolucion në futbollin e Kosovës. "Ky sukses ka ardhur si rezultat i punës paraprake. Fadil Vokrri është personi më meritor për gjithë këtë sukses, pasi ai ishte nismëtari i revolucionit të madh në futbollin tonë, duke filluar nga pranimi në UEFA dhe FIFA, krijimi i një skuadre serioze të përfaqësueses e deri te punët e tjera që janë të shumta në futbollin vendor", ka shtuar ai.

Kosova në dy ndeshjet e fundit ka arritur fitore bindëse, duke shënuar nëntë gola dhe mos e pranuar asnjë. Sahiti e ka quajtur të jashtëzakonshëm shënimin e katër golave ndaj një kombëtare siç është jo e Azerbajxhanit. "Nëntë gola në dy ndeshje është një e arritur e jashtëzakonshme. Shënimi i katër golave, e në anën tjetër mospranimi i asnjë goli ndaj një kombëtare si Azerbajxhani, është diçka e madhe. Kemi krijuar një përfaqësuese të fortë, pasi një vit nuk kemi pësuar humbje. Prej nëntë ndeshjeve të zhvilluara brenda një viti, kemi arritur shtatë fitore dhe dy barazime", ka pohuar Sahiti.

Kundërshtar i radhës në gjysmëfinale për Kosovën është Maqedonia. Sahiti nuk ka ngurruar të flasë rreth ambicieve që kanë "Dardanët" për të ardhmen, duke paralajmëruar se kualifikimi në Evropian është synim kryesor. "Kemi kohë deri te përballja me Maqedoninë që zhvillohet në mars të vitit 2020. Deri atëherë mund të bëhemi skuadër më e mirë dhe normalisht pritet të ketë edhe prurje të reja të futbollistëve. Maqedonia është kundërshtare e fortë, por synimi ynë është kualifikimi në Evropian", ka thënë Sahiti, i cili ka punuar edhe si ndihmëstrajner i Albert Bunjakit, që ishte përzgjedhës para zviceranit Bernard Challandes. Ai e ka vlerësuar lart punën e Bunjakit, derisa lavdëron edhe punën e përzgjedhësit aktual. "Edhe Alberti ka bërë një punë të mirë në përfaqësuese dhe është pjesë e këtij suksesi. Ndërsa trajneri i tanishëm është shumë serioz në punë dhe ka përvojë të madhe. Jemi me fat që e kemi një përzgjedhës të tillë, i cili është duke bërë një punë të jashtëzakonshme", ka shtuar ai.

## Cana uron Kosovën dhe familjen e Fadil Vokrrit

Ish-kapiteni i ekipit kombëtar të Shqipërisë, Lorik Cana, e ka uruar Kosovën për arritjen historike në futboll, promovimin në Ligën C të Ligës së Kombeve dhe sigurimin e një vendi në "play-off" për kualifikime në Kampionatin Evropian 2020. Cana ka shkruar në "Instagram": "Një urim shumë të madh djemve dardanë për fitoren, lojën dhe kualifikimin fantastik për gjysmëfinalen. Një urim special Gramozit dhe familjes së legjendës tonë, Fadil Vokrrit, që të gjithëve na mungon".

# Pasurohen 'Dardanët'

Përfaqësuesja e Kosovës, pas suksesit të arritur në Ligën e Kombeve, është pasuruar me 500 mijë euro nga Qeveria e Kosovës dhe 750 mijë euro nga UEFA. Për pjesëmarrje Kosova merr edhe 750 mijë euro të tjera



EPOKA E RE VETON ZYMBERI

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Suksesi historik i Përfaqësueses së Kosovës, i arritur në Ligën e Kombeve, i ka sjellë edhe përfitime të mira financiare Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur të mërkurën ka marrë vendim që ta shpërblejë Përfaqësuesen me 500 mijë euro. Në fakt, këtë propozim e kishin bërë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi.

Kryetari Veseli ka falënderuar Qeverinë e Republikës së Kosovës që ka mbështetur propozimin e tij për të ndarë 500 mijë euro për përfaqësuesen e Kosovës në futboll për sukseset e arritura deri më tash. Ai ka thënë se Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm në shumë sporte, andaj edhe përkrahja për sportistët dhe investimet në infrastrukturën sportive do të rriten. "Falënderoj Qeverinë e Republikës së Kosovës që mbështeti propozimin tim për të ndarë 500 mijë euro për Përfaqësuesen e Kosovës në futboll, për suksesete arritura deri më tash. Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm në shumë sporte, andaj edhe përkrahja për sportistët dhe investimet në infrastrukturën sportive do të rriten", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Kjo nuk është e tëra, pasi "Dardanët" i kanë argëtuar rreth një milion euro edhe nga UEFA. Kosova do t'i fitojë saktësisht 750 mijë euro shtesë nga UEFA, duke u bazuar në rregulloret financiare të organit qeverisës së futbollit. Kuptohet, kjo shumë do t'i shtohet shumës prej 750 mijë eurove që Kosova do t'i marrë nga UEFA vetëm për pjesëmarrje në këtë garë, që nënkupton se shuma e përgjithshme që do ta inkasojë FFK-ja nga UEFA është 1.5 milion euro. Kosova arriti të dalë e para në grupin e 3 të Ligës D, pasi në ndeshjen e fundit e mundi Azerbajxhanin, me rezultat 4-0.

## Sadiku përfundimisht i Kosovës

Prishtinë, 21 nëntor - Loret Sadiku përfundimisht do ta përfaqësojë Kosovën në të ardhmen. Emri i mbrojtësit ishte në listën e Christian Panuccit për dy ndeshjet e fundit të Kombëtares së Shqipërisë, por kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka konfirmuar se Sadiku do të jetë përfundimisht pjesë e "Dardanëve". "Emri i parë që do të bashkohet me Kosovën është Loret Sadiku, të cilit do t'ia përfundojmë dokumentacionin. Sigurisht se ka edhe të tjerë, por Loret Sadiku na ka mbetur peng nga ato ndeshjet miqësore. Pastaj ishte gjendja e tij e keqe në dokumentacion, që do të marrë një rrugë tani", ka thënë Ademi.



# Kosova në vazon e pestë, Shqipëria në të katërtën

**Prishtinë, 21 nëntor** - Me përfundimin e ndeshjeve në grupe të Ligës së Kombeve, UEFA ka zyrtarizuar edhe vazot për shortin e eliminatoreve të Evropianit të ardhshëm. Vetëm në vazon e pestë renditet Kosova, e cila ka shkëlqyer me paraqitjet e veta në Ligën e Kombeve, duke u kualifikuar si e para në grup. Në vazon e pestë është edhe Maqedonia, e cila është kundërshtare e radhës për Kosovën në "play-off"-in e Ligës së Kombeve. Ashtu siç pritej, Shqipëria do të bëjë pjesë në vazon e 4-t, duke zbritur me një shkallë krahasuar me eliminatoret e Kupës së Botës 2018, ku Shqipëria ishte në vazon e tretë. Në vazon e parë bëjnë pjesë edhe katër kombëtaret që fituan grupet respektive të Ligës A në Ligën A të Ligës së Kombeve dhe për faktin se në qershor të 2019-s, Holanda, Portugalia, Zvicra dhe Anglia do të diskutojnë mes tyre trofeun e parë të Ligës së Kombeve, në eliminatore të 4-ta këto përfaqësuese do të shortohen në grupe me 5 ekipe. Gjermania është surpriza e vërtetë këtij shorti pasi me barazimin e Polonisë ndaj Portugalisë, kombëtarja e pancerave ka zbritur në vazon e dytë dhe të gjithë duan ta evitojnë.



Vazoja e parë: Anglia, Portugali, Holanda, Zvicra, Spanja, Belgjika, Italia, Kroacia, Franca dhe Polonia.
Vazoja e dytë: Gjermania, Bosnja Hercegovina, Çekia, Danimarka, Islanda, Rusia, Suedia, Ukraina, Uellsi dhe Austria.
Vazoja e tretë: Finlanda, Irlanda e Veriut, Norvegjia, Irlanda, Serbia, Sllovakia, Turqia, Bullgaria, Izraeli dhe Skocia.
Vazoja e katërt: Shqipëria, Qipro, Estonia, Gjeorgjia, Greqia, Lituania, Mali i Zi, Estonia, Hungaria dhe Rumania.
Vazoja e pestë: Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjibraltari, Kazakistani, Kosova, Luksemburgu, Maqedonia, Moldavia dhe Ishujt Faroe.
Vazoja e gjashtë: Andorra, Letonia, Lihtenshtajni, San Marino dhe Malta.

# Toronto mezi e mposhti Orlandon

**Orlando, 21 nëntor** - Toronto ruan kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores 93-91 ndaj Orlandos në sekondat e fundit. Një përballje emocionuese dhe me rivalitet mes dy ekipeve, ku në periodën e fundit loja ishte shumë dramatike. Fournier realizoi 27 pikë për vendësit, por që s'mjaftuan për ta ndalë humbjen, ndërsa për kanadezët u dallua Leonardi me 18 pikë. Me vështirësi fiton edhe Portlandi, që mundi 118-114 New Yorkun jashtë fushës. Mysafirët zhvilluan një periodë të katërt të shkëlqyer, duke përmbysur njujorkezët që ishin afër fitores, por gabuan në fund. McCollum me 31 pikë e Lillardi me 29 ishin dy liderët në fushë për Portlandin, raporton "Telesport". Humbje e papritur për clippersat që, pas pesë fitoresh, ndalin hapin e tyre. Washingtoni fitoi 125-118 ndaj ekipit kalifornian një ndeshje të dominuar nga vendësit, ku Walli realizoi 30 pikë e Beali 27, duke i bërë të pavlefshme 29 pikët e Harrisit për Clippersit. Fiton edhe Brooklyni, që mundi 104-92 Miamin, sfidë me luhatje nga të dyja ekipet, me Russellin që realizoi 20 pikë për miqtë (52 pikë erdhën nga lojtarët e stolit).




**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Orlando - Toronto | 91-93 |
| Washington - Clippers | 125-118 |
| Miami - Brooklyn | 92-104 |
| New York - Portland | 114-118 |

## SHKURT

### Zeneli nuk e përjashton transferimin te Fenerbaçe

Ylli i Kosovës në futboll, Arbër Zeneli, shënoi tre gola në ndeshjen e Ligës së Kombeve ndaj Azerbajxhanit (4-0). Zeneli po kërkohet nga skuadra e Fenerbaçes, kurse nuk e ka përjashtuar mundësinë e transferimit në kampionatin turk. "Jam i fokusuar te skuadra ime. Çfarë do të ndodhë në janar apo qershor, nuk e di, do të shohim. Tani për tani jam i fokusuar te skuadra ime. Agjenti merret me gjithçka", ka thënë Zeneli.

### Të dielën turneu "Adem Jashari" në karate

Federata e Karatesë e Kosovës njofton të gjitha klubet nga të gjitha trojet shqiptare se më 25 nëntor në Prishtinë do të mbahet turneu ndërkombëtar "Adem Jashari". Garat do të zhvillohen në të gjitha grupmoshat (7-17 vjeç si dhe seniorët), në të dy gjinitë (femra dhe meshkuj), në dy disiplina, kata dhe kumite. Grupmosha 7-9 vjeç gara do të ketë vetëm në disiplinën e katave, ndërsa në kategorinë e seniorëve paraqitja është falas. Turneu kushtuar figurës së komandantit legjendar "Adem Jashari" do të fillojë nga ora 10:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.

### Januzaj dhe Depayn, afër rikthimit në United

Futbollisti shqiptar Adnan Januzaj dhe holandezi Memphis Depay mund të rikthehen në "Old Trafford", pasi Manchester Unitedi ka klauzola të riblerjes së kontratave me të dy futbollistët. Januzaj dhe Depay u larguan nga Unitedi pasi nuk bënin pjesë në planet e trajnerit Jose Mourinho por, sipas "The Sun", ata mund të rikthehen sërish në Premierë Ligë dhe Unitedi.

### Joshua: Do t'i mund 'top-10' boksierët, një e nga një

Pushimet kanë mbaruar për Anthony Joshua, që është rikthyer në vendlindje dhe në palestër, duke nisur përgatitjet për duelin e tij të radhës, më 13 prill, në stadiumin "Wembley" të Londrës. Për momentin nuk ka një rival zyrtar edhe pse lista e kandidatëve është e gjatë. Joshua ka postuar një video nga stërvitja me pesha në palestër, duke shkruar: "Më i fortë se kurrë. Do t'i mposht me 'KO' të gjithë 'top-10' boksierët e peshës së rëndë, një e nga një". Një premtim ky i boksierit britanik, që synon të bëhet kampioni i padiskutueshëm i botës në peshën e rëndë.

### Cavani: 'Topi i Artë' duhet t'i takojë një francezi

Sulmuesi i Uruguait, Edison Cavani, mendon se "Topin e Artë" duhet ta fitojë një futbollist francez. "Varane është një ndër kandidatët, Grizmann dhe Mbappe gjithashtu. Duhet shikuar me kujdes performanca dhe jo vetëm emri i tyre. Për mendimin tim, 'Topi i Artë' duhet t'i shkojë një francezi. Modriqi bëri një sezon të shkëlqyer, por Varane fitoi Ligën e Kampionëve së bashku më Botërorin", ka thënë Cavani.

### Blatter: Infantinon po keqpërdor FIFA-n

Ish-presidenti i FIFA-s, Sepp Blatter, ka sulmuar ashpër presidentin aktual të qeverisë së futbollit botëror, Gianni Infantino. Sipas Blatterit, në FIFA mungon transparenca për të ashtuquajturën "Reforma e FIFA-s" që është prezantuar në vitin 2016. "Ajo që më shqetëson është fakti që Infantino nuk po tregon letrat mbi tavolinë. Ai po punon pas krahëve të njerëzve të tij dhe po keqpërdor kështu besimin e institucionit. Ku është transparenca? Kështu nuk mund të bëhet", ka thënë Blatteri që më tej vazhdon akuzat. "Infantino është presidenti i FIFA-s dhe nuk mund të krijojë një organizatë tjetër që t'i shesë kompeticionet. Kjo nuk lejohet me statut. Ndaj kërkoj nga komisionet përkatëse një audit të hollësishëm në FIFA", ka thënë Blatteri për "Bild".



| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | USHQIM PREJ BRUMI TË THARË | MBISHKRIMI NË NJË GUR VARRI | LLOJ SHALE PREJ DRURI ME DY KAPTEJ TË LIDHUR ME BRINJË | ELEKTRON, TITAN | VARIOLË | ZANORE | EPOKA E RE | EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN | BIMË BARISHTORE QË KA VLERA TË MËDHA USHQIMORE | | PUSI I UJIT / HISTORIANI ROMAK LUKRECI |
| | | | | | | NDODHI QË TREGOHET ME GOJË; TREGIM ME GOJË (krah.) | | | | | | | QË DO ZGJIDHJE TË SHPEJTË (mjek.) / POLITIKANI GAZMEND | | | | |
| | | | | | | GJENDJE PLOGËSHTIE SHPIRTËRORE | | | | | | MËNYRË ARTIFICIALE E EPSHIT / SHTERPË | | | | | |
| | | | | | | LËNDË MËSIMORE | | | | | GRILL (sh.shq.) / GRIMCAT MOLEKULARE | | | | | | |
| | | | | | | PËREMËR VETOR | | | | ATEMATIK, JO TEMOR / AXHAMI, JO I RRITUR | | | | | | | VËNIE E MINAVE |
| | | | | | | RRALLËSI (Lat.) | | | | | | | | PORTIERI HOWARD (EVERTON) / AKTORJA AMERIKANE THIESSEN | | | |
| | | | | | | OHAJO, FLORIDA | | | FUTBOLLISTI ALVARO ...... (R. MADRID) / BASHKËT. | | | | | | | ZANORE / PADITËS I SOKRATIT | |
| | | | | | | AGJËRIMI (krah.) | | | | | | | ZANORE / ARKA SHTETËRORE (Lat.) | | AGRON NIKA / KLUB FUTBOLLI NË SPANJË | | |
| EPOKA E RE | KËNGËTARJA NË FOTO | SONDAZHI | GRACKË PËR TË ZËNË ZOGJ | PORTIERI KASILLAS | SËPATË E VOGËL (sh.shq.) | ZANORE / ELIZABETH TAYLOR | | AKADEMIKU STAVILECI | MJET KOMUNIKIMI / PJESË E MISHTË E TRUPIT TË NJERIUT | | | | | | | | |
| E LUIHATSHME NË QËNDRIME | | | | | | | E TREMB / KRYEQYTETI I KANADASË | | | | | HUMORISTI ..... KIÇINA / THIKA QË MBAHEJ SI ARMË BREZI | | | | | |
| E PËRZIER | | | | | | | | | | | FLEGËR / ISH FUTBOLLIST I NJOHUR BRAZILIAN | | | | | | DJALL (hebr.) |
| GRUP I PËRBËRË PREJ TETË KËNGËTARËSH | | | | | | TON, ALUMIN / MJET I THJESHTË LUNDRIMI (sh.shq.) | | | | KRYEQYTETI EVROPIAN I MODËS / QYTET I LASHTË NË ILIRI | | | | | | BASHKËT. / GJYNAH | |
| NEON | | | KRYEQYTETI I MAROKUT (pashq.) / SHTET NË AZI | | | | | | BAKRI / KËNGË E POPULLARIZUAR | | | | | AKTORJA E FAMSHME THURMAN / E FRIKËSOJ SHUMË DIKË | | | |
| TRAJNERI GJERMAN REHAGEL | | | | TANTAL, VOLT / AIR TRAVEL ORGANISERS LICENSING | | | | MUZIKANTI ADRIAN / MICHIGAN EDUCATION ASSOCIATION | | | | | PJATAT / PUSIA | | | | |
| KËNGËTARJA VALENTINA | | | | | SPIKERJA ...... MURTEZI - SHALA / PRAROJ | | | | | | | GRUAJA E MOSHUAR / PUSULLAT | | | | | |
| ZANORE | | SULM / GJENDJE E PA PUSHTET (shq.) | | | | | FUTBOLLISTI SAMUEL ... / MOTAK | | | | JO E VJETËR / ZANORE | | | | ALESANDRO NESTA / SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE | | |
| PEIZAZHI I GJERË | | | | | | | | | VLERËSIM ME NOTË (sh.shq.) / VDEKJEPRURËS | | | | | | | | ARTI I VALLEVE ME FIGURA, QË LUHEN NË SKENË NGA DISA VETA |
| OLIVER NEUVILLE | | | LLOJ LOJE FATI / MUZIKANTI .... DHOMI | | | | | FINLANDA, ISLANDA / DY BASHKËTINGËLLORE | | | I THAJ / NJËSI KOHE | | | | | BASHKËT. / QË IA PRET MENDJA; I SHKATHËT | |
| DAFINË | | | | BASHKËT. / KËSTI BANKAR PËR KTHIMIN E KREDISË | | DIREK I ÇATISË / ZILI, INAT | | | | VEGËL MUZIKORE / KULAÇE | | | | | | | |
| KOHË E NDARË PËR PUNË | | | | | E VRARË NË LUFTË / DOCUMENTAR EDUCATIONAL RESOURCES | | | | | | | | PARAARDHËS I ITALIANËVE | | | | |
| EKIP | | | | | | | | GURRAT / DY BASHKËTINGËLLORE | | | | | PJESË E LOJËS NË TENIS (sh.pashq.) / JEMENI, INDONEZIA | | | | |
| | | | | | | | UÇK (ang. shk.) / ARSENAL | | | | ADEM JASHARI / ZANORE | | | KRAHINË NË SHQIPËRI / NANTES | | | |
| SHPEND GRABITQAR ME SQEP TË KTHYER E ME KTHETRA / ALI ALIU | | | REPERI AGUSHI | | | | | | DRYNI | | | | | | | | |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA –SUHAREKË**
**MUNICIPALITY SUHAREKË**
**OPSTINA- SUVA REKA**

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**
**06- Nr- 111- 73953**
**Me datë 21.11.2018**

Duke u bazuar në Nenit 11 paragrafi 1 dhe 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr- 03 / L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe sipas Rregullores 02 Nr/2010 për procedurat e Rekrutimit, nenit 24 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ ( Shëndetësi ) 08/2017 dhe pas marrjes së autorizimit nga MAP/DASHC, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë këtë:

**K O N K U R S**
**Për plotësimin e vendit të punës**

**Vendi i punës:** Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare MSK / 140
**Përgatitja Profesionale:** Diplomë Universitare – Mjek Specialist nga Mjekësia Familjare
**Drejtoria**: Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
**Kategoria funksionale / Grada : Niveli Drejtues / 6 ( Koeficienti H- 944 sipas listës së pagës)**
**Lloji i emërimit:** Me afat të caktuar ( mandat 4 vjeçar me orar të plotë )

**Numri i Referencës: RN00004060**
**Detyrat e Punës :**

1. Menaxhon punën e përgjithshme të QKMF-së dhe cakton objektivat dhe zhvillon planet për përmbushjen e ketyreve objektivave;
2. Menaxhon stafin e QKMF, dhe në bashkëpunim me drejtorin, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore;
3. Në pajtim me politikën shëndetësore , Ligjin për Shëndetësi të Kosovës dhe strategjinë e kujdesit parësor shëndetesor, i propozon për miratim DSHMS planin e punës dhe buxhetin e QKMF për vitin vijues;
4. Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF;.
5. Analizon dhe vlerëson cilësinë e shërbimeve shëndetësore që i ofrohen pacientëve me qëllim të zbatimit të ndryshimeve për rritjen e efikasitetit në punë dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore;
6. Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me shëndetësinë primare dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;
7. Të zhvillon marrëdhenie të mira me donatoret, OJQ dhe me parteneret për zbatimin e projekteve të tyre;
8. Kryen detyra të tjera të caktuara nga ana e drejtorit të drejtorisë ;

**Kushtet:**

- Të ketë përgatitje – Diplomë Universitare – Mjek Specialist nga Mjekësia Familjare
- Të ketë pesë vite përvojë pune profesionale pas diplomimit
- Te ketë referenca lidhur me programet trajnuese.
- Njohuri të kompjuterit.

**Shkathtësitë: Të ketë aftësi Psiko Fizike**
**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Fotokopja e vërtetuar e Diplomës Universitare – Mjek Specialist nga Mjekësia Familjare
- Dëshmi për përvojën e punës
- Dëshmi lidhur me programet trajnuese
- Licencën e punës
- Ekstraktin e Lindjes
- Fotokopjen e Letërnjoftimit
- Certifikatën shëndetësore ( me rastin e përzgjedhjes )
- Certifikatën që ndaj tij / asaj nuk zbatohen hetimet.

**Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.**
Aplikacionet e pa kompletuara sipas kushteve të konkursit si dhe ato qe arrin pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.
Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen testimit dhe intervistës.
Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.
Aplikacionet do të merren zyrën e Personelit Nr-16 dhe dorëzohen ne Zyrën Pritëse.
**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas publikimit në mjetet e informimit**

Drejtoreshë e DSHMS-ë
Sale Bytyçi

## NJOFTIM

Njoftojme te gjithe klientet se Kompania **"Karademir asansor insaat enerji" SHPK**, me seli ne Prizren, ka marre vendim te shuaje biznesin me numer te regjistrimit: **810068248** dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te gjithe klientet qe kane raporte Kreditore-Debitore ne kete shoqeri qe te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazete.

## OBAVESTENJE

Obavjestavaju se svi klienti da Tvrtka **"Karademir asansor insaat enerji" L.L.C.,** u Prizrenu, doneo odluku da ugasi biznis po br.registra **810068248** i ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postuka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company **"Karademir asansor insaat enerji" L.L.C.** in Prizren, has come to the decision to quit its business with registry: **810068248.** The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA –SUHAREKË**
**MUNICIPALITY SUHAREKË**
**OPSTINA- SUVA REKA**

Direkcija za zdravstvo i socijalnu zaštitu
06- Br- 111-73953
Dana 21.11.2018 godine
Na osnovu člana 11, stav 1 i člana 18 stav 1 Zakona Br- 03 / L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova i u skladu sa Pravilnikom 02 Br/2010 o procedurama zapošljavanja, člana 24. stav 2. Administrativnog uputstva (Zdravstvo ) 08/2017 i nakon dobijanja ovlašćenja od MPA / DCSA, Direkcija za zdravstvo i socijalnu zaštitu objavljuje sledeće:

**K O N K U R S**
**Za popunjavanje radnog mesta**

Radno mesto:: Direktor Glavnog centra za porodično zdravlje MSK / 140
Stručna sprema: Univerzitetska diploma – Lekar specijalista iz oblasti porodičnog zdravstva
Direkcija: Zdravstvo i socijalna zaštita
Funkcionalna kategorija / Rang: Upravni nivo / 6 (Koeficijent H-944 prema platnom spisku)
Vrsta imenovanja: Na određeno vreme (mandat u trajanju od 4 godine sa punim radnim vremenom)
Referentni broj: RN00004060
Radne obaveze:
1. Upravljati ukupnim radom GOPZ-a i utvrđuje ciljeve i razvija planove za ispunjavanje ovih ciljeva;
2. rukovodi osoblje GOPZ-a, u saradnji sa direktorom, organizuje rad kroz razmenu zadataka među zavisnicima, daje smernice i nadgleda rad osoblja na pružanju kvalitetnih proizvoda i usluga;
3. U skladu sa zdravstvenom politikom, Zakonom o zdravstvu Kosova i strategijom primarne zdravstvene zaštite, predlaže DZSZ usvajanje plana rada i budžeta za narednu godinu OCPZ-a.
4. Odgovoran je za svakodnevno upravljanje procesom rada OCPZu;
5. Analizira i ocenjuje kvalitet zdravstvenih usluga pruženih pacijentima u cilju implementacije promena za povećanje efikasnosti na radu i pružanje kvalitetnijih usluga;
6. Razvija i predlaže politike vezane za primarnu zdravstvenu zaštitu i nadgleda njihovu implementaciju;
7. Da razvija dobre odnose sa donatorima, nevladinim organizacijama i partnerima za realizaciju njihovih projekata;
8. Vrši druge dužnosti koje mu odredi direktor direkcije;

Uslovi:
- Da poseduje - Univerzitetsku diplomu - Lekar specijalista za porodično zdravstvo
- Da ima pet godina profesionalnog iskustva nakon diplomiranja
- Da ima referencije u vezi programe obuke.
- Da poznaje rad na računaru.

Veštine: Da imaju fizičke i psihičke sposobnosti
Zahtevana dokumentacija:
- Overena fotokopija diploma univerziteta - specijalista porodičnog zdravstva
- Dokaz o radnom iskustvu
- Dokaz o programima obuke
- Licenca za rad
- Izvod rođenih
- Fotokopija lične karte
- Uverenje o zdravstvenom stanju (nakon izbora)
- Uverenje da se protiv njega/nje ne vodi istraga.

Kosovska civilna služba pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu.
Nepotpune aplikacije pod uslovima konkursa , kao i one koje dolaze nakon roka neće se razmatrati.
Izabrani kandidati u uži izbor će biti podvrgnuti testiranju i intervjuisanju.
Samo odabrani kandidati će biti kontaktirani na izbornoj listi.
Prijave se primaju u kancelariji za osoblje broj 16 i dostavljaju se u Kancelariju za prijem.
Konkurs ostaje otvoren 15 dana nakon objavljivanja u medijima

Direktor DZSZ-a
Sale Bytyqi

## NJOFTIM

Njoftojme te gjithe klientet se Kompania **"Amade" SHPK**, me seli ne Prizren, ka marre vendim te shuaje biznesin me numer te regjistrimit: **70893053 dhe numer fiskal 600877693** dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te gjithe klientet qe kane raporte Kreditore-Debitore ne kete shoqeri qe te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazete.

## OBAVESTENJE

Obavjestavaju se svi klienti da Tvrtka **"Amade" L.L.C.,** u Prizrenu, doneo odluku da ugasi biznis po br.registra **70893053 i fiskalni broj 600877693**i ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postuka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company **"Amade" L.L.C.** in Prizren, has come to the decision to quit its business with registry: **70893053 and fiscal number 600877693.** The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.



Sot u bënë tri vite pa ty baba e gjyshi
ynë i dashur

# Avdyl Q. Gjocaj

(11.2.1943-22.11.2015)

Mësues dhe luftëtar
Çdo ditë e vetme për këto tri vite ka qenë plot mall, dhimbje, dashuri dhe krenari!
Faleminderit që na le ballëlartë!
Do të jetosh gjithmonë me ne, në çdo frymëmarrje tonën.
**Me mall të pashuar të kujton familja juaj që le pas.**


ıpko

Lagja Ulpiana | Rr. Zija Shemsiu | Nr. 34 | Prishtinë | 10000 | Kosovë
T 038 700 000 | F 038 700 001 | E office@ipko.net | W www.ipko.com

Data: 21.11.2018
Vendi: Prishtinë, Kosovë
Ref: 0061-11-18
Nga: IPKO Telecommunications LLC

Titulli: Ftesë për ofertim – Këmisha (Uniforma) për stafin e IPKO-s

Të nderuar,

IPKO Telecommunications fton të interesuarit për ofertim konkurues, për Këmisha (Uniforma) për stafin e IPKO-s.

Dokumentacioni me kushtet e përgjithshme për ofertim mund të tërhiqet më **21, 22 dhe 23.11.2018** në zyrën e IPKO-s në Rr. Zija Shemsiu nr.34, Ulpianë – Prishtinë.
Mostra e IPKO-s do të ju prezantohet të interesuarve me rastin e tërheqjes së dokumentacionit me kushtet e përgjithshme, në adresën e lertëcekur.

Në rast të interesimit, ju mund ta dërgoni ofertën tuaj në adresën e lertëcekur, jo më vonë se **27.11.2018, ora 15:00h**. Oferta dhe mostrat duhet të jenë të futura në zarf/ambalazh dhe të shënohen qartë me titullin e qëllimit.

Sinqerisht

IPKO Telecommunications
Ulpianë, Rr. Zija Shemsiu nr.34
10000 Prishtinë



**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria -Vlada-Government***

*Ministria e Infrastrukturës*
*Ministarstvo Infrastrukture*
*Ministry of Infrastructure*

## ANULIM I KONKURSIT

Anulohet konkursi Shpallje për Avancim për poziten, **Udhëheqës/e i/e Divizionit për Ndërtim dhe Rekonstruktim të Rrugëve.** me numër të referencës RN00003935, i shpallur më 31.10.2018 deri 14.11.2018.

Nga aplikuesit për këte pozite kërkojmë mirëkuptim.

## ANULIRANJE KONKURSA

Anulira se konkurs Objavljivanje za avansiranje za položaj **Rukovodilac Divizije za Izgradnju i Rekonstrukciju Puteva**, br. reference RN00003935, objavljen 31.10.2018 do , 14.11.2018.

Molimo prijavljene kandidate za razumijevanje!

TrafikuUrban

**K O N K U R S**

**Pozita e punës**: Zyrtar i Burimeve Njerëzore
**Numri i pozitave**: 1 (një)
**Kohëzgjatja e punës**: 1 vit me mundësi vazhdimi
**Paga mujore**: 336.00 bruto

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Është përgjegjës për punët administrative në Burimet Njerëzore.
- Administronë procedurat për rekrutim të personelit gjatë vitit kalendarik.
- Administronë procesin e konkurseve publike për përsonelin e TU.
- Bënë arhivimin e dosjeve të punëtorëve si dhe mban ne konfidencialitet të plote dosjet e secilit të punësuar në TU.
- Administronë procedurat, rregullat dhe kodet e TU, si dhe përgatite procedurat e komesionit disiplinore në TU.
- Përpunon të gjitha të dhënat statistikore që kanë të bëjn me administrimin e personelit në nivel të TU.
- Përgaditë proceduarat dhe aktivitetet e programit të trajnimeve për stafin e TU.
- Punon në bazë të procedurave të administrimit të personelit, hartimin e procedurave për personelin e TU,
- I përgadit kontratat e punës për të gjithë punëtorët e TU, vendimet për pushim vjetor, në bazë të planit të aprovuar nga Drejtori i Administratës, pregadit Kartelat e identifikimit për punëtorët e TU.
- Mbanë evidenca për pushimet e punëtoreve të percaktuar sipas Ligjit të punës në fuqi.

**Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Diplomë e Shkollës së Mesme të Gjimnazit.
- Përvojë pune (përparësi).
- Shkathtësi në kompjuter.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera të punës dhe komunikim motivues në grupe.
- Aftësi organizative dhe ndërpersonale.
- Të jetë i përgjegjshëm/me, integritet dhe vetëbesim personal.
- Njohja e gjuhës Angleze.

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

- Aplikacionin për punësim i TU (i nënshkruar nga aplikanti/ja)
- Kopja e diplomës së shkollimit.
- Dëshmi mbi përvojën e punës nëse posedon.
- Kopjen e Letërnjoftimit
- Motivuese (e nënshkruar nga aplikanti/ja)

**Informata të përgjithshme:**
-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.
-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
**Mënyra e Aplikimit:**

1. Aplikacioni mund të merret dhe dorëzohet në N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. rr. Tahir Zajmi, nr.43 –Prishtinë (Objekti i gjimnazit matematikor).
2. Aplikimi mund të bëhet edhe përmes e-mailit : punesimi@trafikurban-pr.com
3. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html)

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga data **22.11.2018** dhe përfundon më datë **06.12.2018** në ora 16:00.

**Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara dhe të pa nënshkruara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.**



# OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m2, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m2.
Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.
Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.
Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.**

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Firma "Idea-A" N.T.SH. njofton konsumatorët për zbritje mbi 50 perqind me rastin e pastrimit të stokut (materiale shkollore dhe zyrtare), për fund vit. Na vizitoni në dyqanin tonë rruga "Eqrem Çabej" nr. 13 Prishtinë.

▶ Sadri Gashi shpallë të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Zenel Salihu" Bardh i Madh ish Bellaqev.

▶ Fidan Hyseni shpallë të pavlefshme dëftesë e shkollës fillore "Luigj Gurakuqi" Batllav.

▶ "Euro Driloni" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330158402.

▶ Zeki Toska shpall te pavlefshme dëftesën e vitit lV dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren

▶ Emir Tamniku shpall te pavlefshme diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren

▶ Qendrim Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl l - V dhe Vl - lX SHFMU "Luigj Gurakuqi" Hatmagje.

▶ Agim Vuici shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Burim Shala shpall te pavlefshme Deftesat dhe Diplomen e SH.M.Ekonomike Hoxhë Tasim Hoxha Prishtine

▶ Dibah Canhasi shpall te pavlefshme Deftesat dhe Diplomen SH.M.Gjimnazi "Gjon Buzuku" Prizren

▶ Agron Morina shpall te pavlefshme Deftesat dhe Diplomen SH.M.L. Teknike "11Marsi" Prizren

▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

# NPT AGROKOVRAGA-FRUT

# SHPALL TENDER PER NDERTIMIN E DEPOS

**1 .PLLAKA DHE IZOLIMET E PLLAKES**
**2. KONSTRUKSIONI I QELIKUT ME PANEL FRIGO**
**NUMRI KONTAKTUS 044140588 Kovragë -Istog**
**n-azi.b@hotmail.com**

AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”



Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë

Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.

Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

